



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Arte skenike"  
në profilet : " Regji", " Aktrim", " Balet", " Marrëdhënie  
publike"**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë  
"Universiteti European i Tiranës"**



Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Miltiadh Kutali
2. Dr. Dorina Arapi

Nëntor 2022

**Për Programin e studimit Bachelor në "Arte skenike" në profilet : " Regji", " Aktrim", " Balet", " Marrëdhënie publike"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës (UET)
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Arteve të Aplikuara (Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit Dhe Arteve Liberale)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Arte skenike" në profilet : "Regji", " Aktrim", " Balet", " Marrëdhënie publike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 636, date 20.09.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 528, datë 04.09.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli 1
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite (6 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.A 2018-2019 – 12 PAE/2 PAK V.A 2019-2020 – 21 PAE/4 PAK V.A 2020-2021 – 23 PAE/4 PAK
18	Numri i studentëve të regjistruar:	V.A 2018-2019 (15 studentë) V.A 2019-2020 (17 studentë) V.A 2020-2021 (12 studentë) V.A 2021-2022 (14 studentë)
19	Komente / të tjera:	-

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në "Arte Skenike", me profile, është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 536, datë 07.09.2018. Programi ofrohet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, i licencuar me VKM Nr. 636, date 20.09.2006, dhe i riorganizuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 528, datë 04.09.2018. Fillimisht programi është ofruar me 5 profile, por aktualisht në proces akreditimi do të jenë vetëm 4 nga profilet fillestare.

Programi i Studimit është licencuar nga MASR Bachelor në "Arte skenike" në profilet: "Regji", "Aktrim", "Balet", "Multimedia", dhe "Marrëdhënie publike". Me shkresë Nr. 96 Prot datë 20.04.2021 protokolluar në ASCAL me Nr. 19/5, datë 21/04/2021 IAL kërkoi të akreditoj vetëm profilet "Regji", "Aktrim", "Balet", "Marrëdhënie publike", me arsyen që profilet e tjera i ka joaktive.

Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Bachelor" në "Arte Skenike" me profile: "Regji", "Aktrim", "Balet", "Marrëdhënie publike".

Bazuar në një traditë të rëndësishme e me vlera kombëtare siç është Arti Skenik në Shqipëri, ky program studimi është në përputhje të plotë me nevojën e domosdoshmërinë e fushave artistike, e veçanërisht ato skenike, për të zgjeruar e krijuar vazhdimësi profesionale në vendin tonë. Zhvillimi i këtij programi, mundëson vazhdimësinë e traditës shqiptare në artet skenike, si një vlerë e situar e "shkollës shqiptare".

Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në fushën e Arteve Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji", duke i pajisur ata me njohuritë themelore teorike, e artsitike. Studentët marrin njohuri në disiplinat e mësipërme, gjë e cila u mundëson atyre të jenë të përgatitur me kriteret për punësim që kërkohen në këtë sektor. Në mënyrë më specifike, studentët, në varësi me preferencat dhe strategjinë karrierës së tyre, kanë mundësi të zgjedhin e të orientohen në një nga profilet e ofruara në këtë program studimi.

## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Mbas aplikimit për nisjen e procedurës së akreditimit të programit "Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji", të Universitetit Europian të Tiranës (UET) dhe Urdhërit nga ASCAL për kryerjen e vlerësimit të këtij programi studimi u përcaktuan edhe ekspertët e vlerësimit të jashtëm : Prof. Miltiadh Kutali dhe Dr. Dorina Arapi dhe koordinatores teknike të ASCAL, Arjana Alija

Fazat e vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit "Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji" janë paraqitur si më poshtë:

Grupi i punës së vlerësimit të jashtëm bëri vlerësimin mbi bazë dokumentacioni të paraqitur nga Institucioni aplikues, Universitetit Europian të Tiranës (UET).

1. Aprovimi i agjendës së vizitës në IAL u bë ndërmjet dy anëtarëve të Grupit të Vlerësimit të jashtëm dhe koordinatores teknike të ASCAL, Arjana Alija;
2. Vizita në institucion u krye në datat 11 dhe 12 maj 2022, sipas përcaktimit në agjendë. Grupi i vlerësimit të jashtëm realizoi me përpikmëri takimet e caktuara sipas agjendës.

Ditën e parë, më datë 11 maj 2022 u realizuan:

- Takimi me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale Përgjegjës in e Departamentit të Arteve të Aplikuara;
- Takimi me Grupin e vetëvlerësimit;
- Takim me Përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe zyrës së kurikulave;
- Takim me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi (të brendshëm dhe të jashtëm);
- Takim me përfaqësues të zyrës së projekteve dhe partneriteteve;
- Dhe në fund takimi përmbylles i ditës së parë.

Ditën e dytë, më datë 12 maj 2022 u realizuan:

- Takim me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore;
- Takim me studentët e këtij program studimi;
- Takim me përfaqësues të zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit.
- Vizitë në sekretarinë mësimore
- Vëzhgim i mjedisëve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.) Vizitë në Bibliotekë.
- Takimi përmbylles me Përgjegjës in e Departamentit

3. Hartimi i Draft raportit të vlerësimit të jashtëm dhe dërgimi i tij në Institucion.

*"Universiteti Europian i Tiranës" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 07.11.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 87/128 Prot, datë 07.11.2022. "Universiteti Europian i Tiranës" përcjell në ASCAL komentet përmes AMS dhe me anë të shkresës me Nr. 78/132 Prot., datë 15.11.2022, "Kithim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm", në këtë mënyrë drafti kalon në Raport final.*

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Arte Skenike me profile:  
“Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji”**

**I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka ndërtuar infrastrukturën e duhur fizike dhe ka plotësuar në përputhje me kriteret që përcakton legjislacioni për arsimin e lartë dhe aktet në zbatim të tij, dokumentacionin e nevojshëm për të ofruar programe studimi që nuk bien ndesh me standardet e mësimdhënies dhe interesat kombëtare, të cilat gjithashtu janë në përputhje me vizionin, misionin dhe objektivat strategjik të UET. Në raportin e paraqitur nga institucioni, universiteti ka renditur argumentet për hapjen e këtij programi. Bazuar në një traditë të rëndësishme e vlera kombëtare të artit skenik në Shqipëri, ky program studimi është në përputhje të plotë me nevojën artistike për të zgjeruar e krijuar vazhdimësi profesionale në këto fusha në vendin tonë. Qëllimi i Programit të Studimit Bachelor në Arte Skenike është që të përgatisë profesionalisht studentët, me mundësi integrimi në një kontekst shumë disiplinor pune e global. Programi kërkon të ecë paralelisht me tregun e punës, duke kërkuar të kuptojë trendet e nevojat e tregut të punës, si dhe të respektojë traditën shqiptare, politikat kombëtare dhe rijetëzimin e vlerave kulturore shqiptare. Nga ana tjetër ky program kërkon të krijojë një profesionist që të do të jetë në gjendje të ofrojë një model kulturor duke respektuar traditën e artit Skenik në Shqipëri, dhe duke përqafuar njëkohësisht trendet globale e bashkëkohore, po aq të nevojshme në përfaqshjen e nevojave të reja të tregut të punës.</p> <p><i>Ref. 2. Statuti UET.</i> <i>Ref. 3. Plani Strategjik UET 2015-2020.</i> <i>Ref. 3.1. Plani Strategjik UET 2021-2025.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit BA Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji mbështetet në statutin dhe misionin e UET, i cili ka si synim t'i ofrojë studentëve së pari një bazë të plotë të formimit akademik, si edhe një edukim cilësor e profesional, për të përgatitur studentë në fushën e arteve skenike në profilet e mësipërme. Programi I studimit Bachelor në Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji ofrohet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, në përmbushje të kërkesës aktuale, por edhe të ardhshme të tregut për profesionistë të arteve skenike, në mbështetje të zhvillimit artistik dhe ndërgjegjësimit shoqëror si në rrafshin kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar, si potenciale të rëndësishme për zhvillimin kulturor e arsimor në Shqipëri.</p> <p><i>Ref. 2. Statuti UET.</i></p>

	<p><b>Ref. 3. Plani Strategjik UET 2015-2020.</b>  <b>Ref. 3.1. Plani Strategjik UET 2021-2025.</b>  <b>Ref. 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit BA Arteve Skenike</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit BA Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji është hartuar dhe zbatohet në përputhje me qëllimet e krijimit dhe misionin e institucionit, duke evidentuar një ndër tiparet më përfaqësuese të këtij universiteti, si përsa i përket performancës artistike, ashtu edhe në drejtim të veprimtarisë shumëplanëshe universitare. Në tërësi, ky program studimi plotëson dhe e plotëson ofertën akademike të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Ky program është i hartuar specifikisht duke u bazuar në modelet më të përditësuara kombëtare dhe ndërkombëtare akademike, për ata studentë që duan të studiojnë në fushat e Arteve Skenike, dhe dëshirojnë të zhvillojnë me tej karrierën e tyre artistike në këto fusha, në përputhje me sfidat e tregut dhe institucioneve të artit dhe kulturës. Zhvillimi i këtij programi, mundëson vazhdimësinë e traditën shqiptare në artet skenike, si një vlerë e shtuar e “shkollës shqiptare”.</p> <p><b>Ref. 2. Statuti UET.</b>  <b>Ref. 5. Rregullore e UET</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Profilet e studimeve të cilat ofrohen nga ky program studimi, janë hartuar me qëllim për të përmbushur nevojat që parashtron sot terreni ku lëvrohet arti dhe kultura si brenda ashtu edhe jashtë vendit, për tu inkuadruar në skenën artistike shqiptare, si në nivel kombëtar, ashtu dhe ndërkombëtar. Respektimi deri në detaj i këtyre parametrave, mbetet synim i profileve të Programit të Studimit Arteve Skenike Bachelor, të cilat kanë si qëllim pikërisht arritjen e një konsolidimi dhe modernizmi të artit skenik në Shqipëri. Synimi dhe realizmi i këtij kriteri, u vërejt dhe gjatë bisedave të kryera me stafin pedagogjik gjatë vizitës në institucion. Stafit akademik, në diskutimet e kryera, ndër të tjera paraqiti si synim dhe si një domosdoshmëri të zhvillimit të programit, ndërtimin e një fryme dhe marrëdhënie jo thjesht klasike; pedagog – student por duke ngacmuar dhe rritur modelin e partneritetit dhe krijimin e një raporti të ri shoqëror, duke performuar së bashku në projekte dhe nisma të ndryshme artistike, parë kjo si një vlerë e shtuar e këtij institucioni. Një rol të rëndësishëm për konsolidimin e këtij program, ka dhe Bordi i Tregut të Punës. Për organizimin e programeve të studimit dhe të planeve mësimorë, UET konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve përkatëse, të organizuara në formën e Bordeve të Tregut të Punës në nivel Departamenti, për t’iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës.</p> <p><b>Ref. 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit BA Arteve Skenike.</b>  <b>Ref. 5. Rregullore e UET.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi I.2**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Programi i studimit BA Artet Skenike, me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UET, të përcaktuara në dokumentacionin përkatës si edhe në vizionin, prioritetet dhe objektivat e tij, përcaktuar si në Planin Strategjik 2015-2020, të ri-konfirmuara edhe në Planin Strategjik 2020-2025. Ky institucion ka në epiqendër të politikës dhe veprimtarisë së tij diversifikimin e ofertës akademike e shkencore në drejtime të ndryshme, të cilat janë që vlerësuar se kërkohen dhe plotësojnë nevojat e tregut të punës.</p> <p><b>Ref. 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit BA Arteve Skenike.</b>  <b>Ref.3.2. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.</b>  <b>Ref.3.3. Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025.</b></p>								
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi i studimit është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit, të cilat mbulohen nga Departamenti i Arteve të Aplikuara. Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky program është i organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe çdo akt normativ në zbatim të tij. Në bazë të ekspertizës së kryer konstatohet se; aktualisht ky program ofron mundësi studimi në 5 profile, por vetëm 4 prej tyre janë në fazë akreditimi, të cilat i japin mundësi studentëve të për zgjedhin profilin më të përshtatshëm në bazë të interesave dhe objektivave të tyre akademike dhe profesionale.</p> <p><b>Ref. 16. Argumenta për hapjen e programit BA Arte Skenike.</b>  <b>Ref. 2. Statuti I UET</b>  <b>Ref. 54.1 URDHER Nr.536, date 07.09.2018, Per Hapjen e BA Arte Skenike.,</b>  <b>Ref. 54.2 URDHER Nr.528,date 04.09.2018, Riorganizimin e F. i Shkencave Sociale dhe Edukimit ne F. i Sh. Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale.</b></p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi seprocedurat e përcaktuara sa i takon emërtimit, organizimit, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, bazuar në vendimin e Vendim Nr.41,datë 24.1.2018, “Për elemente te programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” (ndryshuar me VKM, nr.879,datë18.12.2019), si dhe në Vendim NR. 531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”.</p> <p><b>Ref. 14. Kurrikula e programit</b>  <b>Ref. 53.1 VKM Nr. 41_datë 24.01.2018_Elementët e programeve të studimit. .</b></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

**Standardi I.3**  
**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se programi i studimit me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji ka si objektiva të përcaktuara formimin e studentëve, duke përfshirë jo vetëm dijet shkencore që i nevojitet studentit, por dhe aftësitë dhe kompetencat profesionale që janë të domosdoshme në këto fusha artistike. Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formim në fushat skenike, ngushtësisht të lidhura me procesin krijues, për arritjen e objektivave sipas profilit të zgjedhur, me qëllim që kjo diplomë të targetojë kualifikimin e punësimit në fushat e arteve Skenike.</p> <p>Specifikisht kurrikula e programit, bazuar në normat ligjore, reflektohet si më poshtë:</p> <p>20% lëndë nga Kategoria A lende baze  50% lëndë nga Kategoria B lende karakterizuese  12- 15% lëndë nderdisiplinore nga Kategoria C  10-15% lende plotesuese kategoria D  3% - 5% detyrime përmblylëse</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike</b>  <b>Ref. 14. Kurrikula e programit_BAArte Skenike.</b>  <b>Ref. 14.1 Plani mësimor i programit_BAArte Skenike.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në drejtim të zbatimit të politikave të tij, GVJ vëren se në dokumentacionin e shqyrtuar, institucioni periodikisht konsultohet në vijimësi me përfaqësues të bizneseve, të profesionistëve, të cilët janë organizuar në formën e Bordeve të Tregut të Punës, të përshtatur në nivel Departamenti. Bordi mbledhet dy herë në vit, në mënyrë që institucioni të ketë një këshillim dhe feedback nga Bordi, dhe në këtë mënyrë të reflektojë ndryshime të mundshme sipas kërkesave të tregut të punës dhe për të analizuar ecurinë e praktikave. Dekani i fakultetit është përgjegjës për mbajtjen e marrëdhënieve me Bordet e Tregut të Punës. Bordi i tregut të punës, kontribuon në praktikën e studentëve, duke u bërë pjesë e auditorëve si profesionistë të ftuar. Bordi I tregut të punës ofron përvojën e tyre për modelimin e silabuseve dhe programeve, në përshtatje me nevojat e tregut. Hulumtimi dhe vëzhgimi, si dhe këshillat e pasqyruara nga ky bord, kanë shërbyer gjithashtu si bazë për hartimin e kurrikulës të këtij program studimi. Në UET është funksionale dhe e integruar shoqata 'UET ALUMNI', e cila mban kontakte me studentët e diplomuar të programeve të studimit. Në bazë të këtij database, si dhe komunikimit me ish studentët, në bazë të të dhënave statistikore të cilat lidhen me punësimin e tyre dhe përfshirjen në tregun e punës, përftohet një analizë e cila mundëson universitetit dhe departamentit një orientim akoma më të qartë mbi nevojat që ka tregu i punës, dhe përshtatjen e lëndëve teorike e praktike.</p> <p><b>Ref. 2. Statuti UET.</b>  <b>Ref. 12.1 Bordi i Tregut të Punës - DAA.</b>  <b>Ref. 12.4 Takime dhe aktivitete_Bordi i Tregut te Punës.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se objektivat formuese dhe elementët e tjerë të programit të studimit i</p>






<p>programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>përgjigjen kërkesave të tregut të punës dhe i jep mundësinë studentëve të njohin tematikat specifike të ndryshme dhe në fushën e arteve skenike jo vetëm në nivel kombëtar, por dhe atë ndërkombëtar. Programi kombinon njohuritë teorike me praktikën, me qëllimi, për t'i ofruar mundësi studentëve të aftësohen profesionalisht, si në nivel teorik, ashtu dhe praktik, duke njohur dhe zotëruar teknikisht dhe në plan përmbajtësor skenën dhe ekranin.</p> <p><i>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike.</i>  <i>Ref. 14. Kurrikula e programit_BAArte Skenike.</i>  <i>Ref. 14.1 Plani mësimor i programit_BAArte Skenike.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>UET ka një eksperiencë përsa i përket ofrimit të programeve të studimit në fushën e arteve skenike. Kjo gjë ka nisur fillimisht në vitin 2011, më ofrimin e programit BA në Komunikim-Dizajn. Prej vitit 2018, Universiteti ofron një program të riorganizuar BA në Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji. UET ka kapacitetet dhe burimet njerëzore, infrastrukurore dhe financiare, për ofrimin e programit në fushën e arteve skenike. Në këtë këndvështrim duhet theksuar se ekipi akademik i këtij departamenti, përbëhet nga emra dhe personalitete të njohura dhe me një karrierë të gjatë skenike dhe pedagogjike në fushën e arteve skenike.</p> <p><i>Ref. 2. Statuti UET.</i>  <i>Ref. 002. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB – BA Arte Skenike.</i>  <i>Ref. 3. Plani Strategjik UET 2015-2020.</i>  <i>Ref. 3.1. Plani Strategjik UET 2021-2025.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktiveve dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi BA Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji ofrohet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, që është në përputhje me fushën e programit të studimit me fushën e njësisë kryesore përgjegjëse. Në nivel akademik teorik dhe praktik, ky program studimi, ka ekspertizën e nevojshme për t'u shndërruar në një faktor të rëndësishëm në jetën artistike në vend. Programet ofrojnë lëndë me një fokus të qartë praktik. Kurrikula e këtyre programeve i përgjigjet përvojës më të mirë të universiteteve perëndimore, duke e bërë dijen të transferueshme dhe duke iu përgjigjur kërkesave të "Kartës së Bolonjës", në përshatje edhe me ndryshimet social - ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës.</p> <p><i>Ref. 2. Statuti UET.</i>  <i>Ref. 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit_BA Arteve Skenike.</i></p>


<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi BA Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji është në përputhje me fushën akademike të njësisë bazë të Departamentit të Arteve të Aplikuara që ofron programin. Ky konstatim ngrihet mbi bazën e verifikimit të dokumentacionin përkatës dhe mbarëvajtjes sa i përket veprimtarisë dhe të funksionalitetit të kësaj strukture.</p> <p><i>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike. .</i>  <i>Ref. 53.1 VKM Nr. 41_datë 24.01.2018_Elementët e programeve të studimit. .</i>  <i>Ref.53.2 VKM Nr. 531 date 11.09.2018_Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.</i>  <i>Ref. 54.1 URDHER Nr.536,date 07.09.2018, Per Hapjen e BA Arte Skenike,.</i>  <i>Ref. 54.2 URDHER Nr.528,date 04.09.2018, Riorganizimin e F. i Shkencave Sociale dhe Edukimit ne F. i Sh. Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

<p><b>Standardi I.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësi ve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, të cilat sigurojnë ndarjen e detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së detyrave respektive dhe analizës dhe monitorimit të vazhdueshëm cilësor të procesit të mësimdhënies. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi ve është e përcaktuar në rregulloren dhe në aktet e tjera të brendshme të institucionit. Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njësisë të ndryshme, ku njësia bazë është përgjegjëse për programin e studimit. Në njësinë bazë, është e përcaktuar qartësisht roli i përgjegjësit të kësaj njësie, përgjegjësit të grup-lëndëve dhe titullarit të lëndëve. Në aktet rregullatore, janë të përcaktuara qartë, roli i përgjegjësit të njësisë bazë, përgjegjësit të grup lëndëve dhe ato të titullarit të lëndëve.</p> <p><i>Ref. 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</i>  <i>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike.</i>  <i>Ref. 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programeve të studimit_FSHHEAL_DAA_Detyrat e koordinatorit të programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>të huaj. Me qëllim përmirësimit e ofertës akademike, fakulteti ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme për realizimin e praktikës së studentëve, si dhe punësimin e tyre. Gjithashtu, Bordet e tregut të punës, kontribuojnë në praktikën e studentëve, duke u bërë pjesë e auditorëve si profesionistë të ftuar. Bordi I tregut të punës ofron përvojën e tyre për modelimin e silabuseve dhe programeve, në përshtatje me nevojat e tregut.</p> <p><i>Pavarësisht këtyre mekanizmave, rekomandohet angazhimi i ekspertëve, artistëve ndërkombëtarë në fushat e artit bashkëkohor, të ftuar për leksione e seminare ose ëorkshope. Një zgjerim i mëtejshëm i ekspozimit kërkimor kombëtar dhe ndërkombëtar mund të arrihet përmes shkëmbimit dhe bashkëpunimit me universitete e tjera në trevat shqipfolëse, si dhe me pedagogë shqiptarë të cilët janë pjesë e diasporës në universitete ndërkombëtare. Këto pika do të ndikonin në një prani dhe ndikim të programeve përtej kontekstit e arenës kombëtare e të krijohet profili ish-kollës si një 'markë' të identifikueshme në kontekstin kombëtar, si dhe përftuar nga eksperiencia e vendeve të tjera europiane në fushën e arsimit</i></p> <p><b>Ref. 32. DAA-Lista-e-subjekteve-bashkëpunuese-për-programin-dhe-praktikat-profesionale.</b>  <b>Ref. 12.1 Bordi i Tregut të Punës - DAA.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësisia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Arteve të Aplikuara harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit BA Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji. Universiteti European i Tiranës ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera homologe brenda vendit dhe jashtë vendit, me aktorë të biznesit vendas të huaj, si dhe për kryerjen e marrëveshjeve bashkëpunimi institucionale. Kjo është paraqitur në raportin e paraqitur për periudhën akademike 2018-2021.</p> <p><i>Ref. 32. DAA-Lista-e-subjekteve-bashkëpunuese-për-programin-dhe-praktikat-profesionale.</i>  <b>Ref. 35. Raporti analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit</b>  <b>Ref. 34. Listë e marrëveshjeve të bashkëpunimit UET.</b>  <b>Ref. 34.1-14 Memorandume Bashkëpunimi / Marrëveshje</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit për kryerjen e praktikës për studentët, së pari ka krijuar dhe konsoliduar një frymë partneriteti me institucionet kombëtare dhe ato vendore të artit dhe kulturës si edhe me biznesin, duke pasqyruar dhe hapat e ndjekur me dokumentacion dhe praktikë rregullatore edhe nëpërmjet akteve të brendshme, duke ndjekur procedura të caktuara. Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera homologe brenda vendit dhe jashtë vendit, me aktorë të biznesit vendas të huaj, si dhe për kryerjen e marrëveshjeve bashkëpunimi institucionale. Kjo gjë bazohet në hartimin e strategjisë së ndërkombëtarizimit. Programi Erasmus+, u lejon studentëve dhe stafit akademik të kryejnë mobilitete në Universitete të tjera jashtë vendit.</p> <p><b>Ref. 32. DAA-Lista-e-subjekteve-bashkëpunuese-për-programin-dhe-</b></p>

	<p><i>praktikat-profesionale.</i>  <i>Ref. 32.2. B-I-4 Formulari i vetëvlerësimit të praktikës (nga Studenti).</i>  <i>Ref. 33. Trajnime te mëtejshme profesionale - Departamenti Arte te Aplikuara.</i>  <i>Ref. 30.10. Fisha e projektit QAINAL.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Përveç parashikimeve në marreveshjet e bashkëpunimit apo në marrëdhëniet me institucionet ku studentët kryejnë praktikën, procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të rregulluara edhe nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësive të ndryshme të përfshira në këtë proces. Institucioni siguron trajnime profesionale për studentët e diplomuar. Një rol të rëndësishëm luan zyra e Këshillimit të Karrierës, nëpërmjet parapërgatitjes së studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënies së informacionit e asistencës së nevojshme për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale/stazheve/internshipeve të ofruara nga institucione partnere apo dhe më gjerë. Një informacion më të detajuar paraqitet në dokumentin e institucionit mbi praktikat profesionale, ku rendojnë rreth 17 subjekte private dhe publike, ku universiteti i mundëson studentëve mundësitë e praktikës profesionale, si 17 institucione bashkëpunuese.</p> <p><i>Ref. 32. DAA-Lista-e-subjekteve-bashkëpunuese-për-programin-dhe-praktikat-profesionale</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR



<p><b>Standardi II.1</b>  <b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se programet e studimit me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji, janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është i organizuar me 180 ects. Gjithashtu konstatohet se kurrikula e programit i përgjigjet kriterëve dhe parametrave evropianë, duke e bërë dijen të transferueshme dhe duke iu përgjigjur kërkesave të "Kartës së Bolonjës", në përshtatje edhe me ndryshimet social - ekonomike dhe zhvillimet e tregut të dijes.</p> <p><i>Ref. 28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>mobilitetin.</i></p> <p><b>Ref. 5. Rregullore e UET</b></p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit BA Arte Skenike.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Programi i studimit Arteve Skenike me me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji, është i konceptuar në formë të mirëpërcaktuar për të formuar studentë, me nivel sa më profesional ndaj fushave të artit Skenike në Shqipëri.</p> <p>Struktura e programit të studimit grupohen në disa veprimtari formuese nga A – ja deri te E– ja:</p> <p>Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme</p> <p>Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore</p> <p>Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje.</p> <p>Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.</p> <p>Kategoria E: Detyrime përmblylëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues</p> <p>Programi i studimit ofron mundësinë e profilizimit, përmes zgjedhjes së grup-lëndëve të kategorisë C të programit. Studenti mund të zgjedhë një nga këto profile studimi: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji.</p> <p>Kurrikula e programit plotëson kriterin e balancimit të përmbajtjes teorike me atë praktike.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit BA Arte Skenike.</b></p> <p><b>Ref. 5. Rregullore e UET</b></p> <p><b>Ref. 14. Kurrikula e programit BA Arte Skenike.</b></p> <p><b>Ref. 14.1 Plani mësimor i programit BA Arte Skenike.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorisë dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Programi i studimeve organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studime.</p> <p>Programi synon ta pajisë studentin me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit</li> <li>• Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale</li> <li>• Formim qytetar të përgjithshëm</li> <li>• Aftësi bazë për punë kërkimore</li> <li>• Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative</li> <li>• Aftësi për promovim personal</li> </ul> <p>Kurrikula kombinon metodat artistike me ato shkencore, gjë që reflektohet dhe në realizimin e diplomave të studentëve, duke pasur si qëllim dhe zhvillimin kritik ndaj analizës së veprës së artit skenik. Nëpërmjet metodave të ndryshme, e qasjes ndërdisiplinore, programi studimor është konceptuar për ti ofruar studentit që zgjedhë këtë program, një gërshetim të lëndëve shkencore me ato artistike, duke synuar më tej ngritjen e profesionalizmit dhe në fushën akademike, duke ndjekur më tej studime të tjera pasuni versitare.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit BA Arte Skenike.</b></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Objekтиви kryesor i këtij programi është formimi i profesionistëve dhe specialistëve në fushën e Arteve Skenike, të cilët mund të depërtojnë sinë tregun dhe arealin artistik kombëtar, po ashtu dhe atë ndërkombëtar. Në këtë program studenti përfton në aspekte teorike, praktike në fushën e arteve skenike, të cilët më pas mund të avancojnë studimet e tyre dhe karrierën sipas preferencave e profileve që ata dëshirojnë. Kjo gjë është e paraqitur qartë në planin strategjik për zhvillimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji”</p> <p><i>Pavarësisht këtyre mekanizmave, rekomandohet angazhimi i ekspertëve, artistëve ndërkombëtarë në fushat e artit bashkëkohor, të ftuar për leksione e seminare ose workshope. Një zgjerim i mëtejshëm i ekspozimit kërkimor kombëtar dhe ndërkombëtar mund të arrihet përmes shkëmbimit dhe bashkëpunimit me universitete e tjera në trevat shqipfolëse, si dhe me pedagogë shqiptarë të cilët janë pjesë e diasporës në universitete ndërkombëtare. Këto pika do të ndikonin në një prani dhe ndikim të programeve përtej kontekstit e arenës kombëtare e të krijohet profili ish-kollës si një 'markë' të identifikueshme në kontekstin kombëtar, si dhe përftuar nga eksperiencia e vendeve të tjera europiane në fushën e arsimit.</i></p> <p><b>Ref. 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit BA Arteve Skenike.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se struktura e programit të studimit BA Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji përmban të gjithë elementet dhe standardet e duhura, reflektuar në përputhje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Kurrikula e programit është e strukturuar sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni, ku në cdo syllabus paraqitet informacion i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Gjithashtu kurrikula plotëson kriterin e balancimit të përmbajtjes teorike me atë praktike. Programi i lëndës shpjegon përmbajtjen e kursit, si dhe detyrimet që duhet të përmbushë studenti përgjatë kursit. Në të shpjegohen format e zhvillimit të procesit mësimor ku përmban:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Leksioni -shpjegimi i lëndës mësimore nga pedagogu</li> <li>b. Seminari që nxit dhe stimulon aktivizimin e studentëve.</li> <li>c. Leksion/seminari proces i kombinuar i leksionit dhe i seminarit.</li> <li>d. Puna laboratorike që shërben në vlerësimin e aftësive të studentëve nëpërmjet veprimtarive praktike dhe laboratorike në atelier.</li> <li>e. Praktika mësimore ku studenti aplikon njohuritë teorike të marra në auditor, dhe i aplikon ato.</li> <li>f. Detyrat praktike</li> <li>g. Detyra kursi.</li> <li>h. Provimet e ndërmjetme/përfundimtare janë format kryesore të vlerësimit të studentëve.</li> <li>i. Praktika profesionale që është detyrim akademik që synon të lidhë njohuritë teorike dhe praktike të fituara gjatë studimeve me profesionin/et përkatës/e dhe t'i familjarizojë studentët me tregun e punës, e cila është dhe e detyrueshme për të mbrojtur më pas diplomë.</li> <li>j. Punimi i diplomës/Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar është detyrimi</li> </ol>






	<p>përfundimtar i studentit për marrjen e diplomës në përfundim të programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu në syllabus pasqyrohen përmbledhja dhe qëllimet e kursit; Konceptet themelore e terma bazë; Temat e leksionit.</p> <p><i>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike.</i></p> <p><i>Ref. 14. Kurrikula e programit_BAArte Skenike.</i></p> <p><i>Ref. 14.1 Plani mësimor i programit_BAArte Skenike.</i></p> <p><i>Ref. 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</i></p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se lëndët në përmbajtje të kurrikulës janë të organizuara sipas kategorive (A-E), me peshën e përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, e ndryshuar.</p> <p>Studenti fiton:</p> <p>35 kredite ECTS nga lëndët bazë në Kategorinë A</p> <p>96 kredite ECTS –lëndë karakterizuese të kategorisë B</p> <p>24 kredite ECTS - lëndë ndërdisiplinore të profilit</p> <p>18 kredite ECTS - lëndë plotësuese në kategorinë D</p> <p>7 kredite ECTS nga detyrimi përmbyllës, i cili është provim përfundimtar, ose punim diplome, me një total prej 180 ECTS. Një kredit ECTS është 25 orë mësimore, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit.</p> <p><i>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike.</i></p> <p><i>Ref. 5. Rregullore e UET</i></p> <p><i>Ref. 14. Kurrikula e programit_BAArte Skenike.</i></p> <p><i>Ref. 14.1 Plani mësimor i programit_BAArte Skenike.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi II.2</b></p> <p><b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i studimit që ofron universiteti është I licencuar/ hapur me aktet përkatëse, dhe i nënshtrohen procesit të vlerësimit (të brendshëm dhe të jashtëm) dhe akreditimit sipas parashikimeve ligjore dhe dokumenteve të brendshme rregullatore. Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin, të cilat zhvillohen përkatësisht sipas <b>parashikimeve ligjore në fuqi për vlerësimin dhe akreditimin.</b></p> <p><i>Ref. 53.1 VKM Nr. 41_datë 24.01.2018_Elementët e programeve të studimit. .</i></p> <p><i>Ref. 53.2 VKM Nr. 531 date 11.09.2018_Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.</i></p> <p><i>Ref. 54.1 URDHER Nr.536,date 07.09.2018, Per Hapjen e BA Arte</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>Skenike,</i>  <b>Ref. 54.2 URDHER Nr.528, date 04.09.2018, Riorganizimin e F. i Shkencave Sociale dhe Edukimit ne F. i Sh. Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Për secilin program studimi të ofruar nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, është përcaktuar koordinatori i programit. Detyrat e koordinatorit janë të përcaktuara qartësisht në aktet e brendshme rregullatore të Universitetit Europian të Tiranës. Për realizimin e praktikave profesionale, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, shoqata dhe aktorë të punës, gjë e cila është në funksion të punësimit të studentëve, duke ndjekur politikat e nevojat e tregut të punës në Shqipëri. Përmirësimi i praktikave profesionale dhe efektivitetit të tyre në funksion të realizimit të programit akademik, vlerësohen nga një komision i posaçëm dhe nga studentët, ku nëpërmjet një formulari, arrihet të merret një feedback mbi këto praktika dhe mundësitë për ti përmirësuar ato në funksion të përmbushjes së njohjeve teorike -praktike në fushën e arteve skenike.</p> <p><b>Ref. 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</b>  <b>Ref. 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programeve të studimit_FSHHEAL_DAA_Detyrat e koordinatorit të programit.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Programi mbështetet në strategjinë institucionale të UET, të zbatuar konkretisht për studimet në fushën e arteve pamore, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale dhe ato të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe atyre të vet Departamentit të Artevetë Aplikuara. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, i cili është njësi bazë e fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Ky program është ngritur në përputhje me dispozitat ligjore për numrin e njësive bazë në përbërje të njësive kryesore.</p> <p><b>Ref. 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Në program janë të angazhuar në mësimdhënie, pedagogë e artistë, të kualifikuar në fushën pedagogjike por edhe të jetës kulturore dhe artistike të vendit, me titujt të ndryshëm dhe gradat shkencore përkatëse; profesorë me përvojë të gjatë pedagogjike, si dhe artistike, si dhe gjithashtu aplikohen module me lektorë të ftuar, me ekspertë të fushave të arteve skenike. Pjesa më e madhe e personelit të brendshëm janë të angazhuar në veprimtari artistike dhe kulturore si edhe në kërkim shkencor dhe njëkohësisht janë drejtues projektsh kërkimore. Departamenti i Arteve të Aplikuara përmbush detyrimet për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në Departamentin e Arteve të Aplikuara, i cili është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Arte Pamore” rezulton:</p> <p><i>(Viti akademik 2018-2019)</i>  <b>Numri i PAE 9/ Numri i PAK 13</b> nga të cilët 9 PAE:  (3) Prof. Dr.; (1) Prof. Asoc. Dr. ; (3) Dr.; (2) MSc. dhe 13 PAK: (3) Prof. Dr.; (2) Dr.; (8) MSc., pra 22 në total.</p>




	<p>(Viti akademik 2019-2020)  <b>Numri i PAE 12/ Numri i PAK 26</b> nga të cilët 12 PAE:  (3) Prof. Dr.; (2) Prof. Asoc. (2) Dr. (9) MSc dhe 26 PAK: (5) Prof. Dr.; (2) Prof. Asoc. (4) Dr. (1) Dr.proc. (14) MSc, pra 38 në total.</p> <p>(Viti akademik 2020-2021)  <b>Numri i PAE 16/ Numri i PAK 11</b> nga të cilët 16 PAE:  (3) Prof. Dr.; (2) Prof. Asoc.; (2) Dr.; (9) MSc. dhe 11 PAK (2) Prof. Dr. (1) Dr. (1) Dr.proc. (7) MSc, pra 27 në total.</p> <p><b>Ref. 002. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB – BA Arte Skenike.</b>  <b>Ref. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit_Tab 1&amp;2_Aneks.</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Arteve të Aplikuara është njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies, performances artistike dhe të punës kërkimore-shkencore në fushën e arteve, duke përfshirë fushat e kërkimit të përafërta, të cilat janë të organizuara në Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji dhe arte muzikore. Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, institucioni ka të rregulluar mënyrën e strukturën e veprimit të rolit të pjesëtari të saj, dhe të sistemit të funksionimit të strukturës akademike.</p> <p><b>Ref. 16. Argumenta për hapjen e programit_BAArte Skenike.</b>  <b>Ref. 5. Rregullore e UET</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.3</b>  <b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, zotëron të gjitha të dhënat e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Këto janë të reflektuara në statutin, rregulloren e institucionit, rregulloren e programeve të studimit, në strategjinë e institucionit dhe në syllabuset e programet. Syllabuset janë të konsultuara nga përgjegjësi i grup-lëndëve dhe më pas miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Kjo praktikë ndihmon në mos mbivendosjen e temave dhe lëndëve të programit të studimit. Planet mësimore janë hartuar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu kurrikula plotëson kriterin e balancimit të përmbajtjes teorike me atë praktike.</p> <p><b>Ref. 2 .Statuti i UET</b>  <b>Ref. 5. Rregullore e UET</b>  <b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike</b>  <b>Ref. 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit_BA Arteve Skenike.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në</p>	<p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja.</p> <p>i) Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

fuqi.	<p>përgjithshme</p> <p>ii) Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore</p> <p>iii) Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje.</p> <p>iv) Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.</p> <p>v) Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues.</p> <p>Syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit janë të strukturuar sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni, ku paraqitet informacioni i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Planet mësimore janë hartuar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu kurrikula plotëson kriterin e balancimit të përmbajtjes teorike me atë praktike. Programi i lëndës shpjegon përmbajtjen e kursit, si dhe detyrimet që duhet të përmbushë studenti përgjatë kursit, si dhe format e zhvillimit të procesit mësimor ku përmban:</p> <p>a. Leksioni -shpjegimi i lëndës mësimore nga pedagogu</p> <p>b. Seminari që nxit dhe stimulon aktivizimin e studentëve.</p> <p>c. Leksion/seminari proces i kombinuar i leksionit dhe i seminarit.</p> <p>d. Puna laboratorike që shërben në vlerësimin e aftësive të studentëve nëpërmjet veprimtarive praktike dhe laboratorike në atelier.</p> <p>e. Praktika mësimore ku studenti aplikon njohuritë teorike të marra në auditor, dhe i aplikon ato.</p> <p>f. Detyrat praktike</p> <p>g. Detyra kursi.</p> <p>h. Provimet e ndërmjetme/përfundimtare janë format kryesore të vlerësimit të studentëve.</p> <p>i. Praktika profesionale që është detyrim akademik që synon të lidhë njohuritë teorike dhe praktike të fituara gjatë studimeve me profesionin/et përkatës/e dhe t'i familjarizojë studentët me tregun e punës, e cila është dhe e detyrueshme për të mbrojtur më pas diplomë.</p> <p>j. Punimi i diplomës/Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar është detyrimi përfundimtar i studentit për marrjen e diplomës në përfundim të programit të studimit.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike.</b>  <b>Ref.14. Kurrikula e programit_BAArte Skenike.</b>  <b>Ref. 14.1 Plani mësimor i programit_BAArte Skenike</b></p>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi është i organizuar në lëndë dhe komponentë të tjerë (praktika profesionale dhe detyrimet përmbyllëse), të vlerësuara në kredite ECTS. Komponentët janë të ndarë në vite dhe semestra, duke bërë një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mesatare për çdo semestër dhe vit akademik. Programi është i ndërtuar në mënyrë të atillë, ku në vitin e parë zhvillohen kryesisht lëndët e natyrës së përgjithshme, e cila vijon më tej në vitin e dytë e të tretë me lëndë karakterizuese të programit, e lëndët e profilit. Praktika profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, zhvillohen në vitin e fundit të




	<p>programit.</p> <p><b>Ref. 14.1 Plani mësimor i programit BAArte Skenike</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit përmban planin mësimor, pasqyron më mënyrë të detajuar informacionet mbi lëndët dhe komponentët e tjerë sipas semestrave dhe viteve akademike, ngarkesën e shprehur në ECTS, orët në javë, orët mësimore të ndara në leksione, seminare, ushtrime/laborator, format e kontrollit të vazhdueshëm, seancat e praktikave profesionale të zhvilluara në auditor, praktika profesionale, orët në auditor etj, duke ju përmbajtur në këtë mënyrë ligjeve dhe akteve në fuqi.</p> <p><b>Ref. 19.1 Format i Syllabusit Cikli i pare dhe i dyte</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se informacionet që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve gjenden në dokumentet e brendshme, në nivel institucional dhe në nivel programi studimi. Informacionet që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve gjenden në dokumentet e brendshme, në nivel institucional dhe në nivel programi studimi. Duke u bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 'Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, udhëzimeve përkatëse të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, Universiteti European i Tiranës ka të rregulluar transferimet e studentëve, dhe kryen transferimin e studentëve të shkolla të tjera të larta, sipas procedurave të parashikuara. Njohja dhe vlerësimi bazohet në parimet, kriteret dhe instrumentet e Konventës së Lisbonës për Njohjen. Procesi i njohjes kryhet në përputhje me rregullat dhe me procedurat e parashikuara në statutin e UET-it, në rregullore, si dhe të akteve të lëshuara nga ministria e Arsimit.</p> <p><b>Ref. 28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit janë të strukturuar sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni, ku paraqitet informacioni i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Informacioni i detajuar për secilën lëndë të programit të studimit paraqitet në syllabusin e detajuar, i cili konsultohet fillimisht nga përgjegjësi i grup lëndës dhe përgjegjësi i departamentit. Kjo praktikë ndihmon në mos mbivendosjen e temave dhe lëndëve të programit të studimit. Planet mësimore janë hartuar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu kurrikula plotëson kriterin e balancimit të përmbajtjes teorike me atë praktike. Programi i lëndës shpjegon përmbajtjen e kursit, si dhe detyrimet që duhet të përmbushë studenti përgjatë kursit. Në të shpjegohen format e zhvillimit të procesit mësimor ku përmban:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Leksioni -shpjegimi i lëndës mësimore nga pedagogu</li> <li>Seminari që nxit dhe stimulon aktivizimin e studentëve.</li> <li>Leksion/seminari proces i kombinuar i leksionit dhe i seminarit.</li> <li>Puna laboratorike që shërben në vlerësimin e aftësive të studentëve</li> </ol>

	<p>nëpërmjet veprimtarive praktike dhe laboratorike në atelier.</p> <p>e. Praktika mësimore ku studenti aplikon njohuritë teorike të marra në auditor, dhe i aplikon ato.</p> <p>f. Detyrat praktike</p> <p>g. Detyra kursi.</p> <p>h. Provimet e ndërmjetme/përfundimtare janë format kryesore të vlerësimit të studentëve.</p> <p>i. Praktika profesionale që është detyrim akademik që synon të lidhë njohuritë teorike dhe praktike të fituara gjatë studimeve me profesionin/et përkatës/e dhe t'i familjarizojë studentët me tregun e punës, e cila është dhe e detyrueshme për të mbrojtur më pas diplomë.</p> <p>j. Punimi i diplomës/Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar është detyrimi përfundimtar i studentit për marrjen e diplomës në përfundim të programit të studimit.</p> <p>Struktura e programit përmban rubrikat si më poshtë: Informacioni që përmban syllabusi është: emërtimi i lëndës, emri i pedagogut të lëndës, firma, ngarkesa (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë), tipologjia e lëndës, semestrin kur zhvillohet lënda, llojin e lëndës (e detyrueshme ose opsionale), programin e studimit ku ofrohet kjo lëndë, kodin e lëndës, adresën elektronike të pedagogut të lëndës dhe emrin e Drejtuesit të Departamentit përkatës.</p> <p>Gjithashtu në syllabus pasqyrohen përmbledhja dhe qëllimet e kursit, synimet që kursi synon të arrijë; Konceptet themelore e terma bazë mbi të cilat ndërtohet lënda; Temat e leksionit ku paraqitet jepet shpjegimi i hollësishëm i çdo teme të leksionit të ndara sipas javëve, e cila shoqërohet me literaturën përkatëse. Në këtë seksion paraqiten dhe metodat e format pedagogjike që ndihmojnë në procesin e seminarit përkatës; Format e kontrollit të dijeve janë format e vlerësimit të studentëve, të shprehura si përqindje e notës përfundimtare, siç janë niveli i diskutimit në seminare, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit, detyrat praktike dhe provimi përfundimtar., etj; Literatura e detyrueshme dhe fakultative. Në secilin program lënde, reflektohen format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe detyrimet e studentit për lëndën. Syllabuset e çdo lënde depozitohen dhe mbahen nga personeli administrativ i programit apo koordinorja. Ndërsa studentëve i vendosen në dispozicion dhe nëpërmjet sistemit LMS.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike.</b> <b>Ref.14. Kurrikula e programit_BAArte Skenike.</b> <b>Ref. 14.1 Plani mësimor i programit_BAArte Skenike</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Syllabuset pasqyrojnë të gjithë informacionet e nevojshme për lëndën dhe janë të konsultuara nga përgjegjësi i grup-lëndëve dhe më pas miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Planet mësimore janë hartuar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu kurrikula plotëson kriterin e balancimit të përmbajtjes teorike me atë praktike.</p> <p>Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, si dhe kreditet rishikohen në mënyrë periodike, në përputhje me parashikimet në aktet nënligjore dhe aktet rregullatore të universitetit. Ndryshimet propozohen nga Departamenti, Zyra e Zhvillimit të</p>




	<p>Kurrikulave, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, e cila kryhet në konsultim me Bordin e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës, dhe dinamikave të brendshme të institucionit . Ndryshimet e propozuara shqyrtohen në departament, si dhe nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe më pas dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit. Programi ende nuk ka pasur ndryshime në programin e studimit, ku sipas parashikimeve ligjore në fuqi, ndryshimet në program bëhen vetëm pas procesit të akreditimit.</p> <p><i>Ref. 37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve.</i>  <i>Ref. 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</i>  <i>Ref. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i>  <i>Ref. 13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**



<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se organizimi i programit të studimit, nga ngarkesa e përgjithshme dhe ndarja e lëndëve dhe komponentëve të tjerë në kategori A-E, sikurse dhe emërtimi i secilës veprimtari dhe shpërndarja e tyre, përmbush qëllimin dhe objektivat e programit të studimit në funksion të njohurive, aftësive dhe punësimitin e studentëve. Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i) Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme</li> <li>ii) Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore</li> <li>iii) Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje.</li> <li>iv) Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.</li> <li>v) Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues.</li> </ul> <p><i>Ref. 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se organizimi i programit të studimit, nga ngarkesa totale dhe ndarja e lëndëve dhe komponentëve të tjerë në kategori A-E, sikurse dhe emërtimi i secilës veprimtari dhe shpërndarja e tyre, përmbush qëllimin dhe objektivat e programit të studimit në funksion të njohurive, aftësive dhe punësimitin e studentëve. Formimit praktik, i punës konkrete dhe praktikave profesionale në vecanti, i mundëson studentëve aksesin në tregun e punës dhe kërkesat që paraqiten në realitetin shqiptar në këto fusha profesionale.</p> <p><i>Ref. 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</i></p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional.</p>	<p>Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program studimi, dhe kreditet mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional. Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestrat e kohëzgjatjes së programit është e balancuar dhe mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional. Në programin e lëndës pasqyrohen përmbledhja dhe qëllimet e kursit, synimet që kursi synon të arrijë; Konceptet themelore e terma bazë mbi të cilat ndërtohet lënda; Temat e leksionit ku paraqitet jepet shpjegimi i hollësishëm i çdo teme të leksionit të ndara sipas javëve, e cila shoqërohet me literaturën përkatëse. Në këtë seksion paraqiten dhe metodat e format pedagogjike që ndihmojnë në procesin e seminarit përkatës; Format e kontrollit të dijeve janë format e vlerësimit të studentëve, të shprehura si përqindje e notës përfundimtare, siç janë niveli i diskutimit në seminare, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit, detyrat praktike dhe provimi përfundimtar., etj; Literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar.</p> <p><b>Ref. 19.1 Formati i Syllabusit Cikli i pare dhe i dyte.</b>  <b>Ref. 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</b>  <b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike.</b>  <b>Ref.14. Kurrikula e programit_BAArte Skenike.</b>  <b>Ref. 14.1 Plani mësimor i programit_BAArte Skenike</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestrat e kohëzgjatjes së programit është e balancuar dhe e bazuar në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018 <i>Për Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë (ndryshuar me vkm nr. 879, datë 18.12.2019).</i> Nisur nga kurrikula e programit, ndarja e lëndëve qëndron:</p> <p>lëndë bazë/ 15% - 20%/ 35 ects  lëndë karakterizuese/ 50% - 55%/ 96 ects  lëndë ndërdisiplinore/integruese/ 12% - 15%/ 24 ects  lëndë plotësuese/ 10% - 15%/ 18 ects  detyrime përnbyllëse/ 3% - 5%/ 7 ects</p> <p>Kjo ndarje e krediteve sipas kategorizimit të tyre, mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se kurrikula dhe pesha e aktivitetëve formuese është miratuar me hapjen e programit. Frekuentimi i procesit mësimor (leksione, leksion/seminar, seminare) është i detyrueshëm në masën 60% (gjashtëdhjetë). Frekuentimi i orëve laborator dhe praktika mësimore është i detyrueshëm në masën 100% (njëqind).</p> <p><b>Ref. 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</b>  <b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Kjo gjë pasqyrohet si në syllabuset e cdo lënde, po ashtu dhe në inkurajimin e botimeve nga stafi pedagogjik, e po ashtu nga pasurimi i bibliotekës së universitetit. Gjithashtu biblioteka ka krijuar nje katalog me libra elektronik</p>




	<p>ne gjuhe te huaj i cili ka qindra tituj librash ne baze te programeve te studimit dhe qe u vjen ne ndihme studenteve te te gjitha niveleve te studimit. Kjo gjë pasqyrohet në inventarin e librave dhe teksteve për departamentin e arteve të aplikuara, që i nevojiten studentëve dhe pedagogëve gjatë viteve akademike.</p> <p><b>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.</b>  <b>Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.</b>  <b>Ref. 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë.</b>  <b>Ref. 45.3. Shembull procedure_blerje literature.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Në programin e lëndës pasqyrohen përmbledhja dhe qëllimet e kursit, synimet që kursi synon të arrijë; Konceptet themelore e terma bazë mbi të cilat ndërtohet lënda; Temat e leksionit ku paraqitet jepet shpjegimi i hollësishëm i çdo teme të leksionit të ndara sipas javëve, e cila shoqërohet me literaturën përkatëse. Në këtë seksion paraqiten dhe metodat e format pedagogjike që ndihmojnë në procesin e seminarit përkatës; Format e kontrollit të dijeve janë format e vlerësimit të studentëve, të shprehura si përqindje e notës përfundimtare, siç janë niveli i diskutimit në seminare, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit, detyrat praktike dhe provimi përfundimtar., etj; Literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar. Nëpërmjet dijeve artistike, dhe po aq shkencore, kurrikula e programit aftëson studentët në njohjen e koncepteve, dijeve dhe praktikave shkencore arteve skenike; i ofron studentëve njohuri bazë dhe të profilizuara, në një mjedis bashkëkohor dhe shumëdisiplinor, gjë që e kërkon tregu i punës sot dhe trendet e reja botërore.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike.</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Kurrikula kombinon metodat artistike me ato shkencore, gjë që reflektohet dhe në realizimin e diplomave të studentëve, duke pasur si qëllim dhe zhvillimin kritik ndaj analizës së veprës së artit skenik dhe fushave të tjera të lidhura me të. Nëpërmjet metodave të ndryshme, e qasjes ndërdisiplinore, programi studimor është konceptuar për ti ofruar studentit që zgjedhë këtë program, një gërshetim të lëndëve shkencore me ato artistike, duke synuar më tej ngritjen e profesionalizmit dhe në fushën akademike, duke ndjekur më tej studime të tjera pasuniversitare. Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Kjo gjë lehtësohet nga përmbajtja dhe konceptimi i kurrikulës sipas lëndëve të caktuar të cilat formësojnë studnetin në mënyrë sa më profesionale.</p> <p><b>Ref.14. Kurrikula e programit_BAArte Skenike</b>  <b>Ref. 84-175 syllabusët e programit</b></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marri in parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Plani dhe programi mësimor janë hartuar duke mbajtur parasysh gamën e njohuri të nevojshme që garantojnë punësimitin e studentëve të diplomuar në përputhje me objektivat e formimit, kërkesat e tregut dhe trendet e risitë bashkëkohore që janë gjithmonë në ndryshim Në këtë kontekst, për ta avancuar e përmirësuar më mirë këtë qasje, UET bashkëpunon me Bordin e tregut të punës. Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se departamenti realizon mënyrë periodike, mbledhje me anëtarët e Bordit të Punës, për përshtatjen sa më të përputhshme me kërkesat e tregut</p>





	të punës. Në dokumentacion e paraqitur, është pasqyruar gjithashtu një relacion i takimeve të fundit me këtë bord. <b>Ref. 12.1 Bordi i Tregut të Punës - DAA.</b> <b>Ref. 12.4 Takime dhe aktivitete_Bordi i Tregut te Punës.</b>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përmbush kriteret ligjore, si në aspektin e titujve dhe gradave që zotërojnë, ashtu edhe në aspektin e përputhshmërisë së ekspertizës me lëndët ku janë të angazhuar. Në vitin akademik 2020-2021, numri i personelit akademik të angazhuar ka qenë 27 prej të cilëve: Në bazë të VENDIM Nr. 418, datë 10.5.2017, Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve TË ARSIMIT TË LARTË DHE TË DEGËVE TË TYRE, Pika 2, ii) <i>Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi</i>, personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përmbush kriteret ligjore, si në aspektin e titujve dhe gradave që zotërojnë, ashtu edhe në aspektin e përputhshmërisë së ekspertizës me lëndët ku janë të angazhuar.</p> <p>Konkretisht ngarkesa mësimore për cdo vit akademik ka qenë: Në bazë të dokumentacionit të vlerësimit të brendshëm rezultojnë se në vitin akademik 2020-2021, totali i orëve të zhvilluara në këtë program ka qenë <b>2265.5 orë</b>, ku <b>1922.5 orë</b> janë mbajtur nga stafi IAE, dhe <b>343 orë nga PAK</b>. Kjo tregon se stafi PAE ka patur një ngarkesë mësimore, duke përmbushur mbi 70% të normës së ngarkesës mësimore.</p> <p><b>Ref. 02. Tabelat permbledhese 6.1/6.2/6.3/ 12.1/ 12.2/12.3</b> <b>Ref. 176-202 Cv e stafik Akademik</b></p>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme të angazhuar në programin e studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik, përkatësisht me këto tituj studimi:</p> <p>PAE Lektorë me titullin Prof. Dr. - 1 Lektorë me titullin Prof. Asoc. Dr - 3 Lektorë me gradën Dr./Phd. - 7 Asistentë me MSc - 13</p> <p>PAK Lektorë me gradën Dr./Phd. - 1 Asistentë me MSc - 3 Totali – 27 pedagogë</p> <p><b>23 PAE / 4 PAK</b></p>



	<p><i>Ref. 002. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB – BA Arte Skenike.</i>  <i>Ref. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit_Tab 1&amp;2_Aneks.</i>  <i>Ref. 176-202 Cv e stafik Akademik</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Cdo pedagog që është përzgjedhur të jetë pjesë e stafit, është i formuar dhe me aktivitet artistik dhe shkencor sipas fushave të studimit përkatëse dhe studimet e tij kërkimore. GVJ duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe atij të marrë gjatë bisedës me UET, konstaton se niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore personelit akademik në këtë program studimi janë në përputhje me nevojat dhe specifikat që nevojiten.</p> <p><i>Ref. 002. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB – BA Arte Skenike.</i>  <i>Ref. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit_Tab 1&amp;2_Aneks.</i>  <i>Ref. 176-202 Cv e stafik Akademik</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UET është pjesë rrjeteve dhe projekteve të bashkëpunimit universitar, shkencor e akademik me universitetet në BE, OECD, etj., si dhe ka ndërtuar lidhje me universitetet e rajonit të Europës juglindore. Institucioni, në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë, e me përfaqësues të biznesit dhe me stafin e duhur e të kualifikuar, instruktin dhe orienton e udhëheq studentët në praktikën profesionale, për punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera. Procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të rregulluara edhe nëpërmjet akteve të brendshme, ku përfshihen jo vetëm procedurat që duhet të ndiqen, por dhe roli i aktorëve dhe njësive të përfshira në këtë proces. Praktikave profesionale zhvillohen në bashkëpunim me institucioneve apo shoqata, me të cilët universiteti ka vendosur lidhje bashkëpunimi, gjë që është pasqyruar dhe në planin e vizionin strategjik të universitetit. Praktika profesionale e studentëve organizohet, dhe mbikëqyret nga Dekani i Fakultetit, Përgjegjësi i Departamentit përkatës, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Praktikave. Si veprimtari formuese e programit, ajo është e detyrueshme dhe kusht për të përfunduar studimet. Studenti i cili nuk shlyen praktikën profesionale nuk ka të drejtë të mbrojë diplomën.</p> <p><i>Ref. 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale</i>  <i>Ref.35. Raporti analitik i përfutimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Angazhimi i stafit akademik, sipas kualifikimit të nevojshëm, pranë këtij institucioni, në këtë program studimi, siguron mbarëvajtjen e cilësinë e zhvillimit të leksioneve, veçanërisht ato praktike, të cilat lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me programin. Takimet me studentët të programeve shprehën pozitivitet dhe entuziazëm në lidhje me studimet dhe profesorët e përkushtimin e tyre. Studentët konfirmuan se universiteti është gjithmonë i disponueshëm për t'i ndihmuar ata dhe veçanërisht mbështetja e profesorëve gjatë gjithë studimeve. Stafi akademik ndihmës vjen në mbështetje të mbarëvajtjes të procesit mësimor. Nga diskutimet ishte evidente se qendron një respekt i ndërsjellë mes studentëve dhe fakultetit, ku stafi akademik dhe administrativ ndihmojnë studentët e tyre të arrijnë qëllimet.</p> <p><i>Vizita ne institucion</i>  <i>Ref. 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Niveli i përmbushjes</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>




				X
--	--	--	--	---



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Gjatë bisedimeve me stafin akademik, u konstatua, se pedagogët të cilët përftojnë njohuri të reja e metoda të mësimdhënies gjatë shkëmbimeve dhe eksperiencave të përftuara gjatë mobiliteteve akademike. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve. Gjithashtu, universiteti stimulon zhvillimin e metodave të reja dhe inovative. Në këtë aspekt, pedagogët përcjellin informacionet e përftuara tek mësimdhënie, e tek studentët.</p> <p><i>Ref. 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës</i>  <i>Ref. 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit_BA Arteve Skenike.</i>  <i>Ref. 5. Rregullore e UET.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se departamenti vlerëson dhe rregullon rregullisht metodat pedagogjike me, si dhe vlerëson rregullisht cilësinë dhe efektivitetin e mësimdhënies, siç dokumentohet veçanërisht përmes anketave të studentëve. Duke zbatuar procedurat e duhura për trajtimin e ankesave të nxënësve, ndërkohë që siguron drejtimin dhe mbështetjen e duhur nga stafi mësimdhënës; promovon respektin e ndërsjellë në marrëdhënien nxënës – mësues. Strukturat përgjegjëse, si KSBC, zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p><i>Ref. 30.1. Plani veprimi KSBC</i>  <i>Ref. 40. G-III-4-2 Formatit i vlerësimit të pedagogut nga studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të procesit mësimor është një proces i cili ndiqet nga UET, duke venë në përdorur pyetësorëve e formularë të ndryshëm; mbledhjet e hapura e si dhe takime me fokus grupe. Studentët përfshihen në vlerësimin e performancës të personelit akademik, që shtrihet jo vetëm në kuadër të cilësisë së mësimdhënies, por edhe të aspekteve të etikës, mësimdhënies, syllabuseve, etj, apo dhe për të evidentuar dhe adresuar problemet e mundshme. Çdo student ka mundësinë e vlerësimit në mënyrë anonime për çdo lëndë/pedagog në fund të çdo semestri. Ky vlerësim bëhet me anë të formularit “formular vlerësimi i studentëve për pedagogun dhe lëndën” ku shikohet mundësia e vlerësimit të një sërë pikash si mësimdhënia, vlerësimi dhe sqarimi, këshillimi akademik dhe një hapësirë e lirë për komente qoftë për gjera positive dhe negative. Vlerësimi zhvillohet</p>




	<p>online nëpërmjet platformës online LMS dhe rezultatet përpunohen dhe shpërndahen pedagogëve dhe drejtuesve. Institucioni gjithashtu organizon takime periodike në formën e “fokus grupeve” si dhe pyetësorë me frekuencë semestrale rreth problemeve specifike.</p> <p><b>Ref. 30.1. Plani veprimi KSBC</b></p> <p><b>Ref. 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve.</b></p> <p><b>Ref. 41. G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Performanca e pedagogut vlerësohet dhe nga një staf i autoriteteve drejtuese ose i përgjegjësit të Departamentit, ose nga kolegë apo ekspert i jashtëm. Ky vlerësim bëhet duke qenë i pranishëm gjatë procesit mësimor dhe duke plotësuar formularin “Formular për vlerësimin e pedagogut”. Gjithashtu stafi akademik duhet të plotësojë një formular vetëvlerësimi, “formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik”. Në të kërkohet një raportim i gjërë mbi procesin e mësimdhënies dhe lëndët që merr pjesë, procesin e kërkimit, publikimet, projektet ku ka marr pjesë, objektivat e ardhshme, etj. Të gjitha rezultatet i nënshtrohen një përpunimi, vlerësimin periodik raportimin në organet përkatëse nga ana e KBSC-së. Raportet përveç vlerësimit të drejtpërdrejtë të pedagogëve/lëndëve, përfshijnë dhe vlerësime nga KBSC, bazuar në një metodologji të mirëpërcaktuar, në lidhje me organizimin e provimeve, kontrole të syllabuseve dhe ndërtimit të lëndëve. Raportet i vihen në dispozicion pedagogëve përkatës dhe drejtuesve. Rezultatet e vlerësimit për stafin pedagogjik bëhen publike, pas përfundimit të procesit të vlerësimit. Rezultatet e vlerësimit pasi përpunohen nga KSBC, apo zyra e IT në rastin e vlerësimeveon-line. Rezultat i komunikohet autoriteteve drejtuese të UET, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit. Departamenti analizon rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre, dhe merr masa për përmirësimet e nevojshme.</p> <p><b>Ref. Ref. 30.1. Plani veprimi KSBC</b></p> <p><b>Ref. 40. G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka ndërtuar mekanizma për të evidentuar dhe promovuar praktikën e mira rreth vlerësimit të cilët cilësohen si shembuj të mirë që duhen ndjekur në të ardhmen edhe nga anëtarët e tjerë të stafit. Nëpërmjet mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, institucioni siguron cilësisë dhe vazhdimësinë sa më korrekte dhe profesionale të mësimin dhe marrëdhënieve staf-student brenda institucionit. Pedagogët, në bazë të lirisë akademike, kanë mundësi në varësi të lëndës të integrojnë forma dhe metoda alternative. Syllabuset e secilës lënde që i vihen në dispozicion studentëve që para fillimit të vitit, përmbajnë, konceptet themelore dhe temat që trajtohen, metodat pedagogjike, format e kontrollit/vlerësimit të dijes, literature e detyruar, literature e rekomanduar, etj. Duke qenë se profili i këtij programi është artistik, natyrisht që është dhe mbetet thelbësor metodologjia e praktikës e i ndjekjes së ateliesë. Metoda të tjera, referuar dhe në RVB dhe nga takimi me pedagogët dhe studentët, janë diskutimet dhe puna në grup, analiza e rasteve studimore, organizimi i diskutimeve që nxisin mendimin kritik, etj.</p>


	<i>Ref. 001. RVB_BA Arte Skenike</i> <i>Ref. 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit_BA Arteve Skenike</i> <i>Ref. 2. Statuti UET.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Institucioni ka udhëzues përsa i përket mënyrës së ndërtimit të lëndës, në të cilën parashikohen dhe metodat kryesore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Megjithatë, pedagogët në kuadër të lirisë së tyre kanë mundësi në varësi të lëndës të integrojnë forma dhe metoda alternative. Syllabuset e secilës lënde që i vihen në dispozicion studentëve që para fillimit të vitit, permbajnë, konceptet themelore dhe temat që trajtohen, metodat pedagogjike, format e kontrollit/vlerësimit të dijës, literature e detyruar, literature e rekomanduar, etj. <i>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike</i> <i>Ref. 7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Stafi akademik është kompetent dhe profesional në shpjegimin e njohurive e koncepteve të lidhura me programin, duke ofruar një balance të mire përvoja akademike me atë profesionale. Në zhvillimin e lëndëve në auditor përdoren gjithashtu mjete ndihmëse dixhitale, kompjuteri, projektori, etj. Gjithashtu prezantimet dhe bërja e leksioneve online me anë të dy platformave online UET-LMS dhe TEAMS për shkak të pandemisë duke shfrytëzuar dhe mënyrat online të komunikimit që parashikojnë platformat, si forumet apo chat-et, kanë bërë të mundur vijimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, ku pavarësisht mundësisë së ndërveprimit, ka nxjerr në pak vecorinë për këto programe të bërjes mësim në salla duke garantuar një ndërveprim akoma më të ngushtë sic është dhe vetë natyra e programit dhe që numri jo shumë i madh i studentëve mundëson. Gjatë bisedimeve me stafin akademik, u konstatua se pedagogët, zhvillojnë me studentët dhe punë individuale, interaktive dhe gjithëpërfshirëse duke orientuar studentin në mësimnxënien. <i>(vizita ne institucion)</i> <i>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Pjesëmarrja në projekte shkëmbimi/rritje kapacitetesh gjithashtu ka një ndikim shumë pozitiv në përmirësimin e mësimdhënies. Për këtë arsye, institucioni siguron programe trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore. Universiteti organizon në mënyrë periodike Staff Development Day— Ditën e Zhvillimit. Për sigurimin e brendshëm të cilësisë, universiteti siguron dhe trajnimin e pedagogëve, ku personeli akademik përfiton nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere. Në bazë të raporteve, rezultojnë se UET organizon trajnime të personelit akademik me vëmendje dhe ndaj aspekteve të mësimdhënies në mënyrë që të nxiten përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Fokusi është në nxitjen dhe trajnimin e stafit dhe në

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>integrimin e metodave bashkekohore, të cilat përkthehen në mësimdhënies dhe si praktika të mira që të integrohen në proceset mësimore.</p> <p><b>Ref. 001. RVB_BA Arte Skenike.</b> (vizita ne institucion)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. Këtë gjë e tregon dhe e dëshmon përzgjedhja e tyre sipas fushave, si dhe eksperiencia e tyre në fushat përkatëse. Për këtë dëshmojnë cv-të e stafitë pedagogjik që janë personalitete në fushat e tyre përkatëse, si dhe komunikimi që komisioni vlerësues pati me studentë, kishte një feed-back pozitive në lidhje me mësimdhënien, dhe marrëdhien dialoguese, mbështetëse dhe profesionale pedagog-student. Përgjatë vizitës në institucion, u konstatua dhe gjatë bisedave me studentët.</p> <p>(vizita ne institucion) <b>Ref. 176-202 Cv e stafik Akademik</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se departamenti organizon një herë në muaj mbledhje të hapur për studentët e programeve që administron duke dëgjuar sugjerimet dhe problematikat e tyre në lidhje me procesin mësimor. Autoritetet drejtuese dhe përgjegjësit e departamenteve, pasi bëjnë verifikimet e nevojshme të shqetësimeve të ngritura, marrin masa konkrete me qëllim përmirësimin e situatës, ku në raste të caktuara apo specifike, trajtohen deri në mbledhje Rektorati.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit BA Arte Skenike.</b></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Zhvillimi i orëve interaktive, të cilat ndërthurin shpjegimet teoriko - aplikative duke u fokusuar tek ndërveprimi i vazhdueshëm pedagog - student, ku diskutimet, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet janë disa nga instrumentet kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve. Kjo gjë u dëshmuar dhe gjatë intervistave me stafin akademik, por dhe nga bisedat e zhvilluara me studentët. Kjo metodë interaktive student-pedagog, është dhe mbetet një nga metodat më efektive për të përkthyer marrjes së dijes praktike dhe teorike në artët Skenike.</p> <p>(vizita ne institucion)</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se stafi akademik nxit autonominë dhe mendimin kritik të studentëve. Kjo gjë arrihet jo vetëm nëpërmjet literaturës së rekomanduar, por dhe nëpërmjet artikujve shkencorë të dhënë për t'u studiuar në mënyrë të pavarur. Pedagogët nxisin realizimin e detyrave nga ana e studentëve, gjatë orëve të seminarit, si një mënyrë për të nxitur punën e pavarur dhe përfshirjen më të madhe të tyre në procesin e mësimdhënies. Krahas punës individuale, studentët zhvillojnë dhe detyra e punë në grup, gjë e cila rrit ndjeshëm bashkëpunimin midis studentëve gjatë orëve të seminarit. gjithahtu me rëndësi është dhe përfshirja e studentëve në punë kërkimore-shkencore, të cilat realizohen në bashkëpunim të ngushtë me stafin pedagogjik.</p> <p><b>Ref. Dok. A .III</b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>



standardit	gjithësisht	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III.3	
<p><b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme, ku cdo klase është e pajisur me kompjuterë, rrjetet eifi, gjë e cila mundëson realizimin e orëve mësimore, në lëndë specifike, të cilat kanë nevojë për mjedise të tilla. Gjatë vizitës u konstatua se klasat e lëndëve skenike, kishin hapësira dhe ambjente për të zhvilluar leksionet e seminarat.</p> <p><i>(vizita ne institucion)</i></p> <p><b>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ambientet e procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, e vanërisht ato të leksioneve teorike, dhe të zhvillimit të eventeve artistike, të cilat mbahen për realizimin e auditoreve të gjera, evente të gjera, leksioneve të hapura., etj. Pajisjet kompjuterike kanë të instaluar paketën e Microsoft Office 365 me të gjithë softëare-t e saj.</p> <p><i>(vizita ne institucion)</i></p> <p><b>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Për mbarëvajtjen e mësimit e leksioneve të ndryshme, klasat janë të pajisura me kompjutera, me programet e fundit kompjuterike, të cilat garantojnë nga shkolla cdo fillimi viti akademik, sit ë mirëmbajtura me rrjetin eifi. Gjatë vizites ne universitetit, u verejt se UET ka aktualisht 3 salla të dedikuara posaçërisht për artet, të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit.</p> <p><b>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit</b></p> <p><i>(vizita ne institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>UET është dhe një qendër e rëndësishme botimesh universitare, si UET PRESS, gjëe cila u vjen në ndihmë të nevojave të programeve specifike mësimore dhe domosdoshmërisë për të patur në dispozicion të studentëve e pedagogëve literaturën dhe botimet nga më cilësoret. Literatura bazë dhe ndihmëse I vihet në dispozicion studentëve në gjuhën e programit të studimit, si fizike ashtu dhe në formë elektronike, cka garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p> <p><i>(vizita ne institucion)</i></p> <p><b>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit</b></p> <p><b>Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.</b></p> <p><b>Ref. 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit te librave ne biblioteke.</b></p> <p><b>Ref. 45.3. Shembull procedure blerje literature.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kenë mundësi për të aksesuar në bibliotekat online. Në bibliotekë gjenden libra të</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al

<p>të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>botuar në gjuhën shqipe, të cilët janë pjesë e botimeve të vetë institucionit, por dhe botime të tjera të kryera në fushat përkatëse. Cdo student dhe pedagog ka mundësinë e tyre, për të patur akses. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). Biblioteka ka gjithsej 150 vende leximi, 12 kompjutera dhe gjithë ambienti është i mbuluar nga rrjeti Eireless.</p> <p><b>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit</b>  <b>Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, dhe bisedat me studentët, GVJ konstatoi se studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio-vizive etj. Në çdo syllabus të hartuar, është shënuar literatura bazë dhe ndihmëse. Ato i vendosen studentëve në dispozicion, në mënyrë fizike ose elektronike (në sistemin LMS) nga pedagogu i lëndës. Disa tekste ofrohen në gjuhën shqipe, ndërsa të tjera ofrohen në gjuhën angleze, ndërkohë që leksionet përgatiten në gjuhën shqipe nga pedagogu i lëndës. Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage&amp;Ebsco si edhe Questia, ku studentët dhe stafi kanë akses të plotë nëpërmjet të dhënave personale. Institucioni ka një sërë sistemesh, duke nisur nga përgjegjësi i grup lëndëve, drejtuesit dhe KBSC të cilat garantojnë kontrollin për përputhshmërinë e literaturës me objektivat e lëndëve si dhe garantimin e aksesimit të saj në fondin fizik apo dixhital të bibliotekës. Kjo gjë u konstatua dhe nepermjet intervistave me stafin e studentet gjate vizitës në institucion. Vecanërisht, sic shprehën si stafi, ashtu dhe studentët, këto platforma kishin shërbyer më së miri, për zhvillimin e mësimit gjatë periudhës së pandemisë.</p> <p><i>(vizita ne institucion)</i></p> <p><b>Ref. 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</b>  <b>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit</b>  <b>Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka një infrastrukturë laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. Kjo gjë u konstatua dhe gjatë vizitës në institucion, gjatë diskutimeve me stafin mbështetës, dhe konkretisht në vizitën në sallat përkatëse. Kjo mbetet dhe një nga strategjitë prioritare të UET, dhe duke parë një trend në rritjen graduale të numrit të studentëve, GVJ rekomandon avancimin e përmirësimit të tyre në të ardhmen.</p> <p><i>(vizita ne institucion)</i></p> <p><b>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik përdor platformën online UET LMS dhe Microsoft Teams, ku çdo pedagog komunikon me studentët e tij nëpërmjet UET LMS. Platforma UMS-University Management System, shërben si instrument për ruajtjen, administrimit dhe përpunimin e informacioneve që kanë të bëjnë me aspekte të menaxhimit të institucionit, të programeve të studimit dhe të studentëve. Kjo platformë online aksesohet nga stafi administrative përkatës duke përfshirë dhe mundësi në seksione enkas dhe për stafin akademik. Platforma UET LMS-Learning Management System, funksionon si nje database ku gjenden të pasqyruara: literatura për çdo lëndë e materiale</p>

	<p>audio/video; Njoftimet e pedagogut për çdo lëndë dhe për çdo grup; Pikët individuale nga pedagogu për çdo student dhe çdo vlerësim; Kalendar për studentin dhe pedagogun; Dërgimi i detyrave/eseve nga studentët; Mundësi komunikimi mes studentëve dhe pedagogëve; orare, Lista e notave të studentit, informacione të tjera në lidhje me universitetin, etj. Për shkak të pandemisë së virusit COVID-19, universiteti ka vendosur në përdorim dhe platformën Microsoft TEAMS, që ka shërbyer për të realizuar mësimin interaktiv, në distancë. Nëpërmjet kësaj platforme janë realizuar gjithashtu dhe seancat metodologjike për studentët. Cdo staf akademik, administrativ dhe student furnizohet me një e-mail personal me ane të cilave mund të shkëmbehet informacionet. Zyra e IT ka zhvilluar trajnime dhe për pedagogët dhe studentët për zhvillimin e procesit mësimor në platformat online Microsoft Teams dhe LMS. Këto platforma sigurojnë një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit duke garantuar jo vetëm një arkivim dhe përpunim të të dhënave kryesore. Kjo gjë u konstatua dhe gjatë vizitës në universitet, dhe diskutimeve me studentët.</p> <p><b>Ref. 5.1. Vendim Mbi zhvillimin e procesit akademik ne situatën e krijuar nga pandemia COVID-</b></p> <p><b>Ref.5.2. Rregullore tranzitore Mbi vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021.</b></p> <p><b>Ref. 5.3. Rregullore tranzitore Per zhvillimin e procesit akademik gjate Vitit Akademik 2020-2021.</b></p> <p><b>Ref. 46. Manuali i përdoruesit te sistemit UMIS.</b></p> <p><b>Ref.46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</b></p> <p><b>Ref.46.2. UET LMS Guidë për pedagogun.</b></p> <p><b>Ref.46.3. UET LMS Guidë për studentet.</b></p> <p><b>Ref. 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.</b></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Bazuar në raportin e vetëvlerësimit, UET ka nxjerrë një Urdhër Administrativ, nr. 09, date 02/11/2017 "Mbi zbatimin e plate ne procesin mesimor administrativ te platformes UET LMS" ku në kuadër të dixhitalizimit të të gjithë procesit të mësimdhënies dhe menaxhimit të informacionit. Platforma UET LMS-Learning Management System, shërben si një databazë personale për çdo student. Stafi akademik ka gjithashtu akses për lëndët që është pjesëmarrës nga ku mund të menaxhojë literaturën e lëndëve përkatëse, caktimin e detyrave të kursit, depozitimin e leksioneve, vlerësimet, forume diskutimi online me studentët, etj.</p> <p><b>Ref. 46. Manuali i përdoruesit te sistemit UMIS.</b></p> <p><b>Ref.46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</b></p> <p><b>Ref.46.2. UET LMS Guidë për pedagogun.</b></p> <p><b>Ref.46.3. UET LMS Guidë për studentet.</b></p> <p><b>Ref. 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.</b></p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se përpara se studenti të bëjë aplikimin për temë diplome, departamenti i vë në dispozicion ekspertizën e anëtarëve të personelit akademik, me drejtimet ku ata mund të udhëheqin tema. Pedagogët orientojnë studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, duke i asistuar ata me mjetet, instrumentat e nevojshëm për realizimin e diplomës. Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi dhe/ose kërkimi ose nëpërmjet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP). Në funksion të udhëheqjes së</p>



	<p>temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh të shpallur dhe kriteret për paraqitjen e punimit të diplomës përcaktohen me rregullore të veçantë. Studenti duhet të marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike.</p> <p><b>Ref. 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</b></p> <p><b>Ref. 10. Dokumenti B.11. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</b></p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit BA Arte Skenike.</b></p> <p><b>Ref.7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.</b></p> <p><b>Ref. 7.2. Formati i tezës së provimit përfundimtar.</b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Pa përmbushur</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit, që vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore- shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë sipas rregullave në fuqi. Referuar rregullores “Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë”, strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Strukturat hierarkike organizative të UET-it;</li> <li>2. Zyra e Standardeve dhe Cilësisë kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, standardet e cilësisë dhe praktikata e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre.</li> <li>3. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, vlerëson periodikisht veprimtarinë mësimore, kërkimore ose artistike, si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit.</li> </ol> <p><b>Ref. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.</b></p> <p><b>Ref. 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC.</b></p> <p><b>Ref.30.1. Plani veprimi KSBC.</b></p> <p><b>Ref.30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</b></p> <p><b>Ref.30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</b></p> <p><b>Ref. 30.4. Urdhër administrativ mbi përmbajtjen e KSBC.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Në rastin e Programit të studimit njësia bazë përgjegjëse është Departamenti i Arteve të Aplikuara. Bazuar në dokumentin F.VII, me nr. Ref.8, KSBC bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë dhe realizon monitorimin për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron, i cili dhe përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si edhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore. Departamenti përgjigjet për formulimin e profileve, si dhe të përmbajtjeve lëndore të programeve. Departamenti është iniciues i procesit të rekrutimit pasi ky proces në përgjithësi nis në përputhje me nevojat për personel akademik, si dhe për</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>ngarkesat mësimore të miratuara ku për shpërndarjen optimale të tyre është përsëri përgjegjës Departamenti. Departamenti harton sillabuset, kalendaret, caktimin e pedagogut përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të praktikave profesionale, shpërndan e mbledh formularët aplikimin dhe vlerësimin, miraton institucionet e praktikave, etj. Departamenti është gjithashtu përgjegjës për monitorimin e procesit të mësimdhënies, vlerësimin të stafit, ngritjen e komisioneve të posacme për ndjekjen e problematikave, kërkesave për rivlerësime, marrjen e inputeve gjatë mbledhjeve të hapura, rakordimi me zyrat e kurrikulave për përmirësimet e programeve, etj. Departamentet hartojnë në mënyrë periodike raporte dhe vlerësime.</p> <p><b>Ref.30.1. Plani veprimit KSBC.</b>  <b>Ref. 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Cilësia akademike do të garantohet edhe përmes angazhimit, të stafit që me gradat përkatëse shkencore por edhe me personalitete apo ekspertë në fusha të caktura të arteve pamore. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin trajtimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, të cilat stafi akademik i përfton dhe gjatë trajnimeve të ndryshme, brenda dhe jashtë institucionit. Kjo gjë bazohet në planin strategjik të Departamentit të Arteve të Aplikuara, i cili synon, të mbështesë si studentët në avancimin e njohurive të tyre, gjithashtu dhe në mbështetjen e stafit akademik, ku puna, dhe pasurimi i aktiviteteve të tyre, detyrimisht reflektohet më pas dhe në mësimdhënie.</p> <p><b>Ref. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit Tab 1&amp;2_Aneks.</b>  <b>Ref. 33. Trajnime të mëtejshme profesionale - Departamenti Arte të Aplikuara.</b>  <b>Ref.35. Raporti analitik i përfundimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me vizionin e UET se kërkimi shkencor është në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies e mësimnxënies, nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. Pedagogët efektivë të departamentit janë të përfshirë në projekte, përkatësisht: Programi Erasmus: Kjo përfshirje realizohet nëpërmjet mësimdhënies jashtë vendit, në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit, të nënshkurara nga IAL; Projekte tematike: sipas ekspertizës. Aktualisht Departamenti i Arteve të Aplikuara është i përfshirë në projektet, ku njëri prej tyre është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Polyphonia Project është një projekt mbi vlerat dhe traditën polifonike në Shqipëri, i cili po zbatohet në bashkëpunim me disa partnerë të huaj ku janë përfshirë një pjesë e pedagogëve të departamentit.</li> </ul> <p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Nëpërmjet kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirja e këtyre të fundit në veprimtari kërkimore, kompletin transferimin e dijeve nga pedagogu tek studenti.</p> <p><i>Pavarësisht këtyre projekteve, GVJ rekomandon rritjen e mobilitetit të pedagogëve, dhe përfshirjen e tyre të vazhdueshme, si dhe dhe stimulimin e</i></p>




	<p><i>mbështetjen e tyre më tej në ekspozita, biennale ndërkombëtare dhe botime shkencore me impakt e vizibilitet të lartë.</i></p> <p><b>Ref.35. Raporti analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në bashkëpunim me Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit institucionin ofron trajnime 1-ditore ose me gjatë (professional development and research) për të rritur aftësitë e stafit akademik. Trajnime ndahen në katër grupe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajnime për Doktorantë;</li> <li>• Trajnime për Junior Researchers;</li> <li>• Trajnime për Senior Researchers;</li> <li>• Trajnime Metodologjike.</li> </ul> <p>Personeli akademik i UET ka mundësi të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, duke shfrytëzuar edhe përdorimin e metodave dhe eksperiencave të përftuara gjatë periudhave të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmus+ KA1 dhe trajnimeve të herëpashershme nga lektorë të ftuar.</p> <p><b>Ref. Ref.35. Raporti analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</b></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik ka një rol themelor në zbatimin e programeve të studimit. Institucioni ka udhëzues përsa i përket mënyrës së ndërtimit të lëndës, “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës”, megjithatë, pedagogët në kuadër të lirisë së tyre akademike rolin kryesor në organizimin e lëndëve dhe bërjen e syllabuset ku permbajnë përmbledhjen dhe qëllimin e lëndës, konceptet themelore dhe temat që trajtohen, metodat pedagogjike, format e kontrollit/vlerësimit të dijes, literature e detyruar, literature e rekomanduar, etj. Nga diskutimi me stafin akademik reflektohet një angazhim, dhe frymë bashkëpunimi. Gjithahstu studentët konfirmojnë angazhimin e stafit dhe mbështetjen që i jepet atyre. Përveç metodologjive të konsoliduara, shikohet dhe forma më alternative si prezantimet, ekspozitat, vizita studimore, diskutimet dhe puna në grup, analiza e rasteve studimore, organizimi i diskutimeve që nxisin mendimin kritik, etj.</p> <p><b>Ref. 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</b></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Pjesëmarrja në projekte shkëmbimi ka një ndikim pozitiv në përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Pedagogët kanë lirinë të ofrojnë metoda të ndryshme që ndikojnë pozitivisht tek mësimnxënënia, gjë që e kërkon në mënyrë konstante dhe vetë profilet e këtij programi. Ekspozitat, vizitat studimore, diskutimet dhe puna në grup, analiza e rasteve studimore, organizimi i diskutimeve që nxisin mendimin kritik, janë metodologji efikas në nxënien e njohurive.</p> <p><b>Ref. 34. Listë e marrëveshjeve të bashkëpunimit UET.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

**Standardi III.5**  
**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen qartë në një sërë rregulloresh të institucionit dhe bëhen publike. Rregullorja e UET, përmban norma dhe parashikime të nevojshme për kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit. Rregullorja Mësimore e Programit të Studimit përmban informacion të gjerë e të qartë në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve ku përfshihet sistemi i vlerësimit, mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijes, provimet, riprovimet dhe bartja, përmirësimet, etj. Syllabuset e secilës lëndë, përmbajnë gjithashtu një informacion të detajuar për çdo lëndë lidhur me kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale. Të gjitha këto informacione janë publike si dhe i jepen çdo studenti përpara fillimit të programit të studimit në platformat online të UET si LMS apo në ëbin e UET.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit BA Arte Skenike</b></p>								
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të çdo semestri studentëve u vihet në dispozicion syllabusi i secilës lëndë të parashikuar në programin e studimit. Cdo syllabus përmban në brendi informacion të qartë dhe të detajuar për mënyrat e kontrollit, format dhe afatet e vlerësimit të dijeve. Prezantimi syllabusit të lëndës/modulit realizohet nga vetë pedagogët e lëndës/modulit në fillimin e saj si dhe materiali është gjithmonë i aksesueshëm në platformën LMS. Të gjitha lajmërimet/komunikimet dhe informacionet shtesë në lidhje me menyrat dhe datat e dorëzimeve/provimeve si dhe vlerësimet realizohen online nëpërmjet LMS duke garantuar një proces transparent.</p> <p><b>Ref. 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</b></p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Kontrolli i njohurive realizohet nëpërmjet diskutimeve, edhe me detyra të kontrolluara përgjatë seancave mësimore; Detyrave tematike të përgatitura në mënyrë të pavarur nga ana e studentit, por me konsultën e pedagogut të lëndës; Provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar. Në këtë mënyrë student arrin të tregojë njohuritë e përfutuara gjatë vitit akademik, si dhe të dëshmojë njohuritë praktike në fushën e dizajnit e modës.</p> <p><b>Ref. 19.1 Formati i Syllabusit Cikli i pare dhe i dyte.</b></p>								
<p><b>Sikalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Kontrolli i njohurive realizohet nëpërmjet diskutimeve, edhe me detyra të kontrolluara përgjatë seancave mësimore; Detyrave tematike të përgatitura në mënyrë gjysmë të pavarur nga ana e studentit; Provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar. Në rregulloren pasqyrohet se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në mënyrë të vazhdueshme që të nxisë studentin që të jetë sistematik në përvetësimin e njohurive, si dhe të prodhojë një vlerësim më objektiv të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>studentit. Bazuar në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit, provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore dhe në këtë mënyrë eliminohen forma të ndryshme abuzimi dhe rritet transparenca.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit BA Arte Skenike.</b>  <b>Ref.7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.</b>  <b>Ref.7.2. Formati i tezës së provimit përfundimtar.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparençën.</p>	<p>Sistemet elektronike të testimit dhe vlerësimit janë përdorur në të gjitha ato raste kur ka qenë e mundur kjo gjë, pra sipas karakterit të lëndës. Institucioni në bashkëpunim me AADF (Albanian-American Development Foundation) po promovon një sistem të ri vlerësimi elektronik: “clean scoring”. Ky sistem është aplikuar në lëndë të ndryshme: si në nivelin bachelor dhe master. Provimet e studentëve sekretohen duke i pajisur sallat e provimeve me personel të posaçëm monitorues.</p> <p><b>Ref. 001. RVB BA Arte Skenike.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në rregulloren e programit reflektohet kërkesa e studentit për rivlerësim të notës. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit pasi fillimisht është konsultuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai/ajo ka të drejtë të drejtohet Drejtuesit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Drejtuesi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Drejtuesi i Departamentit, ngre një Komision ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit BA Arte Skenike.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>GVJ duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe atij të marrë gjatë bisedës me UET, konstaton se vlerësimi i detyrave të kursit shoqërohet me komente për t'i evidentuar studentëve pikat e tyre të dobëta dhe mënyrën sesi ato mund të përmirësohen. Duke qenë se profile artistike, në bazë të metodologjisë së tyre, pedagogu në mënyrë të vazhdueshme komenton dhe analizon punën e studentit, për të patur rezultate sa më mira.</p> <p><b>Ref. Ref. 7. Rregullore e programit BA Arte Skenike.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe atij të marrë gjatë bisedës me UET, konstaton se vlerësimi i njohurive të studentit shoqërohet me komente. Konsultat me pedagogun duke qenë të vazhdueshme, e cila lidhet dhe me tipologjinë e programit, ndihmon studentin, të përmirësojë ecurinë e nxënësit të tij.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit BA Arte Skenike.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>UET që prej vitit 2015, implementon sistemin antiplagjiature (Turnitin Ephorus) duke garantuar origjinalitetin e punëve të studentit.</p> <p><b>Ref. 001. RVB BA Arte Skenike.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën e studentëve. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Studenti informohet në kohë reale</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	për rezultatet e vlerësimit, përmes sistemit online (LMS dhe UMIS). <i>Ref. 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës</i> <i>Ref.7.1</i> <i>Ref 7.2. Formati i tezës së provimit përfundimtar</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre, duke ndjekur rregulloren përkatëse. Të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe kërkesa për rishikimin e notës janë të garantuara nga institucioni sipas rregulloreve përkatëse. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen rregulloren e programit të studimit. Procesi i sekretimi të tezave, favorizon qëndrimin dhe vlerësimin sa më objektiv dhe të paanshëm të pedagogut ndaj vlerësimit të studentit. Sipas rregullave të pasqyruara në rregulloren e programit, institucioni ndjek hapa dhe procese të cilat arrijnë të vlerësojnë studentin sipas meritës dhe dijeve të nxëna që ai ka marrë gjatë vitit akademik. <b>Ref. 5. Rregullore e UET</b> <b>Ref. 7. Rregullore e programit BA Arte Skenike.</b>			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se kërkesat dhe ankimimet shqyrtohen nga një komision vlerësimi që ngrihet në departament. Procedura dokumentohet dhe arkivohet. Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm. <b>Ref. 5. Rregullore e UET</b> <b>Ref. 7. Rregullore e programit BA Arte Skenike.</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit pajis studentin me njohuri dhe koncepte bazë të disiplinave artistike, si në lëndët karakterizuese ashtu edhe në ato të profileve specifike. Studentët, që përfundojnë studimet në Bachelor në Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji, me dijet që marrin në këtë program, janë të përgatitur dhe të orientuar drejt tregut të punës dhe publikut të targetuar. Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i profesionistëve e të arrijnë të përftojnë dije profesionale, të cilat lidhen ngushtë me kërkesat e tregut të punës si në kontekstin shqiptar, por dhe më gjerë, duke plotësuar në këtë mënyrë nevojat dhe sfidat e reja në realitetin bashkëkohor të arteve skenike. <b>Ref. 7. Rregullore e programit BA Arte Skenike</b>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit	Sipas kurrikulës së programit janë të mirëpërcaktuara lëndët të ndarë sipas kategorisë: Në lëndë bazë, ku studentët marrin njohuri të përgjithshme teorike, si njohuri mbi sociologjinë, filozofinë, shkrimin akademik etj. Këto njohuri i nevojiten studentit për një formim teorik shkencor, si dhe për

(përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>zhvillimin e diplomës. Në kategorinë e dytë, janë lëndët karakterizues, të cilat japin bazat në artistike dhe të multimedias, të cilat janë të nevojshme për të treja profilet. Në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, të cilat janë të ndara sipas profilit. Këtu studenti informohet më gjerë rreth profilit të tij. Gjithashtu kurrikula e programit përmban dhe lëndë plotësuese, të cilat vijnë në ndihmë të plotësimit teroiko-artistik të studentit.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike</b>  <b>Ref. 14. Kurrikula e programit_BA Arte Skenike.</b></p>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	<p>Stafi pedagogjik i programit, ndjek, udhëzon dhe orienton studentin gjatë gjithë ecurisë së lëndës. Vlerësimet rreth dijeve që ka marrë studenti përgjatë lëndës, kryehen nëpërmjet provimeve, detyrave praktike, ushtrimeve individuale apo në grup që zhvillojnë studentët. Gjithashtu pedagogët në përmblyllje të lëndës, bëjnë dhe një panoramë të përgjithshme të temave të trajtuara në lëndë, si dhe gjithashtu duke kryer konsulta të herpashershme dhe bashkëbisedimet e ndërveprimi që realizohet në prezantimin e punimeve në klasa.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike</b></p>
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	<p>Stafi pedagogjik i programit, ndjek, udhëzon dhe orienton studentin gjatë gjithë ecurisë së lëndës. Vlerësimet rreth dijeve që ka marrë studenti përgjatë lëndës, kryehen nëpërmjet provimeve, detyrave praktike, ushtrimeve individuale apo në grup që zhvillojnë studentët.</p> <p><b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike</b></p>
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>GVJ duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe atij të marrë gjatë bisedës me UET, konstaton se pedagogët sipas fushës së tyre të studimit zhvillojnë vazhdimisht leksione të hapura, të cilat mbahen si në kuadër të lëndëve të caktuara të programit të studimit, ashtu edhe si aktivitete ekstrakurrikulare, dhe janë të hapura për t'u adjekur nga të gjithë studentët e interesuar dhe personeli akademik.</p> <p><b>Ref. 002. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB – BA Arte Skenike</b></p>
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studiëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	<p>GVJ duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe atij të marrë gjatë bisedës me UET, konstaton se studentët aktivizohen në mënyrë aktive në punë artistike, dhe po aq shkencore, të cilat realizohen mëvëmendjen e bashkëpunimit e orientimin e pedagogëve. Nëntëvitet efundit, studentët e angazhuar kanë qenë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për punime shkencore ose krijimtari artistike individuale të pedagogëve janë angazhuar <b>10</b> studentë</li> <li>• Për projekte artistike në rang Departamenti janë angazhuar <b>98</b> studentë</li> <li>• Për projekte artistike në rang Fakulteti janë angazhuar <b>96</b> studentë</li> <li>• Për projekte artistike në bashkëpunime të tjera janë angazhuar <b>10</b> studentë.</li> </ul> <p>Këto bashkëpunime si në rang departemnti, e po ashtu fakulteti, përcojnë dhe ndikojnë në përfitimin e dijeve artistike në rrafsh praktik</p> <p><i>Pavarësisht këtyre aktiviteteve, GVJ rekomandon rritjen e mobilitetit të studentëve, dhe stimulimin e mbështetjen e tyre më tej në ekspozita, biennale ndërkombëtare dhe botime shkencore me impakt e vizibilitet të lartë, duke ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në krijimin e urave lidhëse midis studentit dhe krijimtarisë dhe tregut të punës.</i></p> <p><b>Ref. 002. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB – BA Arte Skenike</b></p>




<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>GVJ duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe atij të marrë gjatë bisedës me UET, konstaton se personeli akademik, nxit bashkëpunimin ndërmjet studentëve dhe punën në grup të tyre. Duke qenë se profile artistike, në bazë të metodologjisë së tyre, pedagogu në mënyrë të vazhdueshme komenton dhe analizon punën e studentit, për të patur rezultate sa më mira.</p> <p><b>Ref. 002. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB – BA Arte Skenike</b></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik inkurajon përfshirjen e studentëve, në punën kërkimore shkencore. Këto bashkëpunime si në rang departamenti, e po ashtu fakulteti, përcojnë dhe ndikojnë në përfitimet e dijeve artistike në rrafsh praktik. Staf i akademik kryen studime që lidhen me lëndët që zhvillon, duke përfshirë dhe literaturën në syllabusit e lëndës, duke trajtuar dhe studimet e hulumtimit e tyre dhe me studentët gjatë orëve të seminarit.</p> <p><b>Ref. 002. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB – BA Arte Skenike</b></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Sipas “Strategjisë Kërkimore Shkencore”; Vizioni, pika 1.2, Kërkimi shkencor në UET është në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies dhe përcjelljes së njohurive bashkëkohore tek studentët si dhe përfshirjen e tyre në veprimtari kërkimore të përbashkëta apo dhe individuale.</p> <p><b>Ref. Strategjisë Kërkimore Shkencore”; Vizioni, pika 1.2</b></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Shkëmbimet e personelit akademik në universitetet partnere perëndimore, në kuadër të projekteve Erasmus + KAI, mundësojnë rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira, të cilat adaptohen nga personeli akademik pas rikthimit në UET, dhe të përhapen edhe tek kolegët e tjerë në institucion. Rrjedhimisht, kjo gjë lehtëson mobilitetin e studentëve dhe përshtatjen e tyre me mjedisin e institucioneve pritëse, pasi ata hasin praktika të ngjashme me çfarë kanë përjetuar gjatë studimeve në UET.</p> <p><b>Ref. 33. Trajnime të mëtejshme profesionale - Departamenti Arte të Aplikuara.</b></p> <p><b>35. Raporti analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Niveli i përmbushjes së përbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p><b>Standardi III.8</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Referuar dokumenti B.II, për punimin e diplomës, paraqitet hap pas hapi procedura e ndjekjes e zhvillimit të diplomës. Ky është një informacion të cilin çdo student e ka para se të zhvillojë diplomën. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur dhe kriteret për paraqitjen e punimit të diplomës përcaktohen me rregullore të veçantë. Studenti duhet të marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike. Gjithashtu praktika profesionale që çdo student duhet të kryej,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






	<p>organizohet, dhe mbikëqyret nga Dekani i Fakultetit, Përgjegjësi i Departamentit përkatës, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Praktikave. Si veprimtari formuese e programit, ajo është e detyrueshme dhe kusht i domosdoshëm për të përfunduar studimet. Studenti i cili nuk shlyen praktikën profesionale nuk ka të drejtë të mbrojë diplomën. Zhvillimi praktikës profesionale si detyrim për mbrojtjen e diplomës, garanton dhe implementon praktikën në zhvillimin e diplomës.</p> <p><b>Ref. 10. Dokumenti B.11. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se diplomimi konsiston në dy forma: në përzgjedhjen e një temë të caktuar studimi dhe/ose kërkimi ose nëpërmjet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP). Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendarit takimesh i cili përcaktohet dhe shpallet.</p> <p><b>Ref. 10. Dokumenti B.11. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studentët zhvillojnë seanca metodologjike me udhëheqësit e tyre, që i orientojnë gjatë punimit të saj. Realizimi e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, zhvillohet nëpërmjet procedurave të posaçme, ku provimi i Përgjithshëm Përfundimtar bazohet në disiplinat kryesore të programit të studimit të ciklit të parë. Studenti duhet të marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike.</p> <p><b>Ref. 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik</b> <b>Ref. 10. Dokumenti B.11. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ky program studimi duke qenë në qasje sa shkencore, po aq dhe artistike, personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave. Kjo realizohet duke ofruar dhe tema diplome për të cilët stafi pedagogjik është kompetent, por dhe nevojat e tregut të punës, të cilat orientojnë dhe zhvillimin e diplomave. Kjo gjë mundëson një përputhje dhe një parapërgatitje për nevojat e reja që tregu artistik si kombëtar, dhe ai ndërkombëtar.</p> <p><b>Ref. 10. Dokumenti B.11. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni asiston studentët për zhvillimin e metodave, përpunimin e të dhënave, të përfuara në terren, si dhe analizimin e tyre, për interpretimin sa më analitik. Për organizimin e programeve të studimit dhe të planeve mësimorë, UET konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve përkatëse, të organizuara në formën e Bordeve të Tregut të Punës në nivel Departamenti, për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Dekani i fakultetit është përgjegjës për mbajtjen e marrëdhënieve me Bordet e Tregut të Punës. Bordet e tregut të punës, kontribuojnë në praktikën e studentëve, duke u bërë pjesë e auditorëve si profesionistë të ftuar. Bordi I tregut të punës ofron përvojën e tyre për modelimin e silabuseve dhe programeve, në përshtatje me nevojat e tregut.</p> <p><b>Ref. 10. Dokumenti B.11. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</b> <b>Ref. 35. Raporti analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e</p>	<p>Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike për paraqitjen e punimit të diplomës</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	përcaktohen me rregullore të veçantë. Studenti duhet të marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike. Gjithashtu nëpërmjet platformës sistemin antiplagjiature (Turnitin Ephorus) e implementuar që prej vitit 2015, garanton origjinalitetin e punëve të studentit. <b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike.</b>			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës vlerësohen me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. <b>Ref. 5. Rregullore e UET.</b> <b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike.</b>			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Institucioni ndjek cdo procedurë të duhur për diplomën e studentit me pajisjen e diplomës dhe suplementin e saj, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, dhe bazuar tek aktet ligjore në fuqi. <b>Ref. 5. Rregullore e UET.</b> <b>Ref. 7. Rregullore e programit_BA Arte Skenike.</b> <b>Ref. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.</b>			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht). <b>Ref. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.</b>			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit. Në lidhje me procedurat që kryhen për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe pajisjen e studentit me informacionin e nevojshëm, institucioni i ka të përcaktuara në dokumenta të veçanta. <b>Ref. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e	GVJ duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe atij të marrë gjatë bisedës me UET, konkludon se institucioni ka ngritur dhe ka funksionale strukturën përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit "Arte

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji” e cila është Zyra e Burimeve Njerëzore. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore, përcaktohen midis të tjerash lloji i dokumentacionit (në formë shkresore dhe apo elektronike) që mbahet pranë institucionit dhe personin përgjegjës. Në lidhje me dokumentat që përmban dosja specifike e stafit akademik dhe administrative, institucioni vepron në bazë të udhëzimit për përmbajtjen e dosjes së stafit.</p> <p><b>Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore (Ref. Nr. 11)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit, faqen ëeb të universitetit dhe në informacionin e siguruar nga vizita online, GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, statutin dhe rregulloren e rekrutimeve të UET. UET ka procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të qarta që garantojnë përzgjedhjen e personelit në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore. Kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen dhe vlerësimin e personelit , bazuar në statutit e institucioni dhe në rregulloret e brendshme, konkretisht “Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik” jepen kriteret mbi qëllimin, kriteret, rastet e vecanta, lektorët e huaj, zhvillimi kurseve jashtë UET, përcaktimin e nëvojave për staf të ri, përzgjedhja e kandidatëve për konkurs, zhvillimin e konkursit, komisionet e rekrutimit, lidhjen e kontratave, vlerësimin e performances, certifikimin e personelit, etj. Procesi i rekrutimit është në përputhje me nevojat për personel akademik, bazuar në planet mësimore që zhvillohen në kuadrin e çdo Fakulteti/Departamenti, si dhe ngarkesat mësimore të miratuara. Propozimi i Departamentit paraqitet në Dekanat dhe më pas Zyra e Burimeve Njerëzore shpall publikisht në media dhe në ëbsite-n e UET-it), kriteret, mbledh aplikimet dhe bën një seleksionimi paraprak të kandidatëve që plotësojnë kriteret e shpallura. Kandidaturat e seleksionuara paraprakisht marrin pjesë më tej në një konkurs dhe bëhet përzgjedhja e fituesve në bazë të vlerësimit të një Komisioni Rekrutimi për të vijuar më tej me lidhjen e kontratave përkatëse. Kjo procedure konstatohet dhe nga takimi me përgjegjësit, stafin gjatë vizitës së GVJ ku janë vënë në dispozicion dhe procesverbale dhe materialet.</p> <p><b>Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore (Ref. Nr. 11)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Përditësimi i të dhënave kryhet çdo vit akademik dhe janë të hapura, me konkurs dhe synojnë përzgjedhjen e personave të kualifikuar që zoterojnë grada shkencore. Institucioni disponon udhëzime dhe dokumenta të hartuar që provojnë procedurat dhe kriteret për rekrutimin e personelit. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Për çdo vend vakant njoftimet bëhen në faqjen zyrtare të universitetit <a href="https://uet.edu.al/rreth-uet/">https://uet.edu.al/rreth-uet/</a>, rrjetet sociale. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Në RVB dhe materialet e marra/kërkuara gjatë vizitës janë vënë në dispozicion infot për të treja vitet që program është i reflektuar në sistem. Të dhënat përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, lëndën që mbulon/drejton, titujt dhe gradat, statusi PAE apo PAK, ngarkesa mësimore, CV përkatëse, etj. Gjithashtu jepen të dhëna për përgjegjësit, drejtues</p>




	<p>departamenti, tutorët e praktikave. etj. Bazuar dhe në vizitën e GVJ, është referuar që çdo vit stafi akademik raporton në lidhje me përditesimet e CV-se se vet, publikimet, pjesëmarrjet në konferenca/aktivitete shkencore e artistike, pjesëmarrje në projekte, realizimin e ngarkesës mesimore, etj. Të gjitha të dhënat raportohen fillimisht Departamentit dhe materialet depozitohen më tej dhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Nga shqyrtimi i CV-ve të vëna në dispozicion dëshmohej në përgjithësi një ekperiencë e gjerë në fushën e arteve dhe në përputhje me lëndët që mbulojnë në program.</p> <p><b>(Shembull thirrje për staf akademik (Ref. Nr. 11.1) dhe në gazetën Liberale.</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit të personelit akademik publikohen në faqen zyrtare të UET (si edhe në rrjetet sociale të UET) dhe janë në përputhje me kërkesat dhe specifikat të programit të studimit. Përzgjedhja e personelit bëhet duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm sikurse dhe ekspertizat dhe ngarkesën mesimore.</p> <p><b>Ref. Nr. 5. Rregullore e Universitetit European të Tiranës</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				X

<p><b>Standardi IV.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit dhe informacionet e marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit “Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji”. Dokumenti i vënë në dispozicion nga institucioni, tregon se stafi akademik në përgjithësi ka një ngarkesë mesimore që është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, e cila është e përshtatshme dhe mund të realizohet prej tyre në mënyrë profesionale.</p> <p><b>Ref. 002. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB – BA Arte Skenike.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi angazhimin dhe mbështetjen e UET për kualifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik. Pjesëmarrja pa kosto në të gjitha konferencat që organizon vetë UET. Ndërkohë, gjatë këtij takimi stafi akademik dëshmoi edhe për mbështetjen financiare të marrë për pjesëmarrje në konferenca shkencore jashtë institucionit kur ata i kishin bërë kërkesë këtij të fundit.</p> <p>Institucioni angazhohet në disa drejtime:</p> <p>-Organizimi i trajnimeve specifike në lidhje me metoda inovative të mësimdhënies, përfshirë dhe përdorimin e teknologjive dhe platformave online si platforma TEAMS (për mësimdhënien) dhe LMS (për të gjitha aktivitetet e tjera formuese), të cilat rezultuan vecantërisht të domosdoshme</p>


	<p>gjatë mbylljes për shkak të COVID .</p> <p>-Angazhimi i stafit në projekte ndërkombëtare kërkimore.</p> <p>-Stimulimi dhe krijimi i mundësisë së pjesëmarrjes në konferenca apo aktivitete të organizuara nga vetë UET.</p> <p>-Stimulimi dhe mbështetja e pjesëmarrjes në konferenca apo aktivitete të tjera jashtë UET.</p> <p>-Krijimi i mundësisë së shkëmbimit akademik me institucione partnere në kuadër të projekteve ndërkombëtare.</p> <p>-Publikime në revistat institucionale.</p> <p><b>Ref. 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit_BA Arteve Skenike.</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GVJ konkludon se ka aktivitete të zhvilluara në funksion të kualifikimit dhe zhvillimit të stafit, trajnimit mbi metoda inovative dhe dëshmon për pjesëmarrje në aktivitete dhe konferenca të ndryshme. Në bashkëpunim me shumë institucione shtetërore ose private ofrohen trajnime 1-ditore ose me gjatë për të rritur dhe zhvilluar aftësitë e stafit akademik për të ndërmarrë punë kërkimore të pavarur që të jetë e botueshme në revista shkencore me faktor impakti. Trajnimet ndahen në katër grupe:</p> <p>(1) Trajnime për Doktorantë;</p> <p>(2)Trajnime për Junior Researchers;</p> <p>(3)Trajnime për Senior Researchers;</p> <p>(4) Trajnime Metodologjike.</p> <p>Gjithashtu, kryhen trajnime nga Zyra e TIK, për përdorimin e sistemit LMS, për pedagogët, në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies në UET dhe menaxhimit më efektiv të tij.</p> <p><b>Ref. 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit_BA Arteve Skenike.</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konkludon si nga dokumentacioni i dorëzuar ashtu dhe gjatë takimit se ka përpjekje maksimale nga institucioni për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore zhvillon procesin e rekrutimit të stafit akademik. UET ka dhe në rregullore të posaçme në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës mesimore “Mbi kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mësimore”, kun ë të citohet se drejtuesi i departamentit përgjigjet për respektimin e shpërndarjen e ngarkesës tek personeli akademik bazuar në rregullat dhe kriteret e ligjit dhe vetë institucionit. Përsa i përket infrastrukturave, nga vizita e kryer në institucion dhe nga të dhënat e raportit, rezultojnë që stafi është vënë në kushte të mira për të kryer detyrat e tij në mënyrë profesionale, duke iu referuar këtu ambjenteve për pedagogët, kushtet e klasave, labororet, atelier-et, bibliotekat, etj.</p> <p><i>(Takimi me burimet njerëzore)</i></p> <p><b>Ref. 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

**Standardi IV.3**  
**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas**



Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Godinat në të cilën zhvillohen aktivitetet mësimore dhe të tjera, të këtij programi studimi është e pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program. Dokumenti i vënë në dispozicion nga Institucioni pasqyron të dhënat infrastrukturore në funksion të programit të studimit. Ambjentet janë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se mësimi zhvillohej gjatë ditëve të javës, në orarin 8.00-16.00. Studentët konfirmuan që leksionet dhe prezantimet e tjera zhvilloheshin duke përdorur edhe mjete audiovizive të cilat disponoheshin nga pedagogu i departamentit përkatës përgjegjës për mbulimin e lëndës.</p> <p><i>Pavarësisht plotësimit të këtij kriteri, Institucioni vë në dispozicion laboratorë-atelje për zhvillimin e mësimdhënies dhe praktikës mësimore. Pavarësisht punës së kryer derimë tani, rekomandohet që të vijojë pasurimi i tyre për të garantuar një përditësim sa më të mirë të tyre.</i></p> <p><b>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (vizita ne institucion)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se hapsirat e nevojshme në funksion të programit të studimit “Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji” janë salla seminaresh, leksionesh, studio pune dhe dy skena dhe biblioteka. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë në sipërfaqe optimale dhe bashkëkohore. Ato janë të pajisura me kompjuter dhe videoprojektor për të lehtësuar procesin mësimor. Dy skenat kanë përmasa të mjaftueshme dhe janë të pajisura me mjete bashkëkohore ndriçimi dhe audio duke bërë të mundur realizimin e çdo produksioni skenik,</p> <p><b>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (vizita ne institucion)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ konkludon se institucioni disponon mjediset e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit specifik. Mësimi zhvillohet në salla leksioni të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore, foni dhe internet.. Dy studiot/skenat kanë përmasa të mjaftueshme dhe janë të pajisura me mjete bashkëkohore ndriçimi dhe audio duke bërë të mundur realizimin e çdo produksioni skenik.</p> <p><b>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (vizita ne institucion)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni konkludojmë se FSHHAL disponon 2 skena. Studentët mund të punojnë si në studio/skene, klase ashtu edhe në bibliotekë për realizimin e detyrave të kursit dhe realizimin e produksioneve skenike.</p> <p><b>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (vizita ne institucion)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose</p>	<p>Praktikat mësimore realizohen në institucionet private ose publike me të cilët UET ka marrëveshje. Studentët mund të diskutojnë me tutorin e</p>

<p>në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>praktikave mësimore, apo pedagogë të tjerë të programit të studimit, për orët e praktikës. (400-orë në total- 200 orë për vitin e dytë dhe 200 orë për vitin e tretë) janë të programuara që të zhvillohen në vendin e praktikës.  <i>Duke patur parasysh që vitet e Pandemisë ndaluan dhe detyruan universitetet ti përshtateshin një realiteti të ri, dhe UET mori një sërë masash konform problematikave të reja dhe zgjidhjes së tyre. Si pasojë, e vendimit të marrë nga Senati akademik, praktikat profesionale u zhvilluan online përmes platformës Microsoft Teams, ku ishin të ftuar pjesëtarë nga Bordet e Tregut të Punës apo aktorë të ndryshëm të biznesit në Shqipëri. Duke qenë se programi ka një qasje artistike me bazë metodologjinë praktike, kjo ka paraqitur vështirësi tek studentët në zhvillimin e praktikave profesionale, pasi krejt veprimtaria e subjekteve publike dhe private e ndryshoi qasjen e saj ndaj publikut, gjë e cila e kushtëzoi zhvillimin e praktikës në mënyrë më të drejtpërdrejtë me zhvillimin, organizmin dhe angazhimin me kohë të plotë në projekte apo programe specifike.</i>  <b>Ref. 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit_BA Arteve Skenike.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbyshet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbyshet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbyshet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbyshet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi IV.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dërguar nga institucioni dhe vizitës online, GVJ konstatoi se FSHHAL vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar pranë këtij universiteti një sallë biblioteke me 103 vendë leximi.  <b>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga takimi online me përfaqësues të institucionit konkludojë se në dispozicion të bibliotekës ka një fond të konsiderueshëm të përbërë nga libra, periodik, CD dhe harta), në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj. Aksesit i literaturës së programit nga studentët, garantohet nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Literaturës fizike në bibliotekë, e cila pasurohet vit pas viti.</li> <li>2. Stafit akademik parashtron kërkesën për blerjen e literaturës nëpërmjet plotësimi të formatit përkatës</li> <li>3. Aksesit në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia</li> <li>3. Katalogut të librave elektronik e krijuar nga biblioteka, i cili ka në gjuhë të huaj qindra tituj;</li> <li>4. Materialeve të vëna në dispozicion nga titullarët në sistemin .UET LMS.</li> </ol> <p><b>Vizita ne biblioteke)</b>  <b>Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.</b>  <b>Ref. 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit te librave ne biblioteke.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të</p>	<p>Gjatë vizitës dhe nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se Institucioni</p>




<p>krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>ofron abonimin në bibliotekat elektronike Sage, Ebsco dhe Questia dhe kapacitete infrastrukurore në bibliotekë (PC, ëi-fi) garantojnë përmbushjen e këtij kriteri. Në RVB dhe nga biseda me pedagogët, deklarohet që pasurimi i bibliotekës bëhet në mënyrë të vazhdueshme në bazë të kërkesave të Departamentit por dhe të pedagogëve të vecantë duke mundësuar sigurimin e titujve të kërkuar në fillim të vitit akademik me anë të blerjeve të teksteve universitare dhe librash të tjera që janë pjesë e lëndëve përkatëse të kurrikulave. Blerjet janë të tiplogjive të ndryshme, nga ato nga panaiuret, blerjet online, abonime online, etj.</p> <p><i>(vizita ne institucion)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e gjithë studentëve.</p>	<p>Nga vizita në këtë bibliotekë rezultoi se ajo është e pajisur me pajisjet kompjuterike me qëllim kryesor aksesimin e shpejtë të bibliotekave online. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). COBISS. Net është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën bibliografike (katalogun) të përbashkët të të dhënave dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse.</p> <p><i>Vizita ne biblioteke)</i></p> <p><b>Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.</b></p> <p><b>Ref. 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave ne biblioteke.</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga takimi në institucion konkludon se ka veprimtari nga institucioni për shtimin e zërave të bibliotekës. Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. UET bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer studentëve dhe pedagogëve. Procedurat e pasurimit të bibliotekës, janë të përcaktuara edhe në dokumentat që rregullojnë veprimtarinë e Institucionit. Në këto institucione ku studentët realizojnë praktikën mësimore, shfrytëzojnë të gjithë burimet e tyre logjistike dhe jo vetëm, për të rritur praktikitetin e tyre.</p> <p><i>Vizita ne biblioteke)</i></p> <p><b>Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.</b></p> <p><b>Ref. 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave ne biblioteke.</b></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka ofron akses shfrytëzimi të barabartë për të gjithë studentët nga e Hëne- Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00-17:00. Ndërsa gjatë sezonit të provimeve është e hapur me orar të zgjatur. Informimi i studentëve mbi oraret e funksionimit të bibliotekës bëhet dhe me anë të njoftimit në mjediset e institucionit.</p> <p><i>(Vizita ne biblioteke)</i></p> <p><b>Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.</b></p> <p><b>Ref. 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave ne biblioteke.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>






**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se UET përdor si sistem të menaxhimit të brendshëm një sistem të quajtur UMIS. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj.</p> <p>Një nga funksionet kryesore të UMIS është: Sistemi i Menaxhimit të Studentit, i cili përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, së bashku me rezultatet e provimeve ndër vite. Gjatë takimeve me studentët ata u shprehën se e shohin sistemin mjaft praktik dhe funksional.</p> <p><i>Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.</i>  <i>Ref.46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</i>  <i>Ref.46.2. UET LMS Guidë për pedagogun.</i>  <i>Ref.46.3. UET LMS Guidë për studentet.</i>  <i>Ref.46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.</i>  <i>Ref.46.5. Raport ecuria e mësimit online.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit, UMIS administrohet informacione dhe dokumentacion për të gjithë të angazhuarit në këtë program studimi. Pedagogët e aksesojnë sistemin duke regjistruar hap pas hapi vlerësimet e studentëve. Sistemi shfaq siguri pasi veprimet janë të gjurmueshme. Sistemi shërben edhe për të ngarkuar elektronikisht regjistrat e pedagogëve si dhe ngarkesën e tyre mësimore. Fizikisht regjistrat arkivohen në zyrën e kordinatorës përkatëse.</p> <p><i>Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.</i>  <i>Ref.46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</i>  <i>Ref.46.2. UET LMS Guidë për pedagogun.</i>  <i>Ref.46.3. UET LMS Guidë për studentet.</i>  <i>Ref.46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.</i>  <i>Ref.46.5. Raport ecuria e mësimit online.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët, stafi akademik dhe stafi administrativ; stafi administrativ luan një rol kyç në përditësimin dhe hedhjen e vazhdueshme të të dhënave. Stafi akademik gjithashtu ka akses të dedikuar për menxhimin e lëndëve të zhvilluara dhe komponentëve të vlerësimit total të studentëve. UET në kuadër të digjitalizimit të procesit të mësimdhënies, ka vënë në përdorim platformën UET LMS (Learning Management System), duke filluar nga viti akademik 2016-2017. UET LMS është standardi më bashkëkohor i përdorur nga të gjithë universitetet prestigjioze në botë në informatizimin e procesit të mësimdhënies online. Aktualisht, sistemi UET LMS është azhurnuar më të gjithë informacionin bazë si: Janë regjistruar të gjithë studentët në lëndët e tyre përkatëse dhe kanë akses të plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin por jo në materialet e</p>




	<p>lëndëve që nuk i përkasin;  <i>Ref. 46. Manuali i përdoruesit te sistemit UMIS.</i>  <i>Ref.46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</i>  <i>Ref.46.2. UET LMS Guidë për pedagogun.</i>  <i>Ref.46.3. UET LMS Guidë për studentet.</i>  <i>Ref.46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.</i>  <i>Ref.46.5. Raport ecuria e mësimit online.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ konstanton që materialet për lëndët që zhvillohen në këtë program studimi ju dërgohen kryesisht përmes adresave të unifikuara të e-mailit. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe komunikimit është shumë efektiv dhe në adresimin e problematikave të ndryshme të studentëve dhe pedagogëve gjithashtu.  <i>Ref. 46. Manuali i përdoruesit te sistemit UMIS.</i>  <i>Ref.46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</i>  <i>Ref.46.2. UET LMS Guidë për pedagogun.</i>  <i>Ref.46.3. UET LMS Guidë për studentet.</i>  <i>Ref.46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.</i>  <i>Ref.46.5. Raport ecuria e mësimit online.</i>  <i>(Takimi me studentet)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Platforma LMS është edhe një mjet eficient në dispozicion të KSBC-së, por jo vetëm, për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të akademik, përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem. Në përfundim të çdo semestri nxirren statistikat përkatëse për çdo pedagog në lidhje me përdorimin e LMS-së.  <i>Ref. 46. Manuali i përdoruesit te sistemit UMIS.</i>  <i>Ref.46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</i>  <i>Ref.46.2. UET LMS Guidë për pedagogun.</i>  <i>Ref.46.3. UET LMS Guidë për studentet.</i>  <i>Ref.46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.</i>  <i>Ref.46.5. Raport ecuria e mësimit online.</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuara nga institucioni dhe nga kqyrja e faqes zyrtare ëeb të UET, konkludon që informacioni që lidhet me këtë program studimi, programet e lëndëve, të dhënat rreth personelit akademik dhe aktivitete të ndryshme që zhvillohen publikohen në faqen e internetit "<a href="http://www.uet.edu.al/">http://www.uet.edu.al/</a>" në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Të gjithë elementët e mësipërm në terma të detajuar janë të publikuara në gjuhën shqipe, ndërsa në terma më të përgjithshëm janë publikuar në gjuhën angleze. Përdorimi i rrjeteve sociale si Facebook, Instagram, shërbejnë gjithashtu, si një mjet komunikimi për të publikuar aktivitetet që zhvillohen në UET. UET ka ndërtuar faqen e re e cila është në gjuhën shqipe edhe në gjuhën angleze.  <i>Ref. "<a href="http://www.uet.edu.al/">http://www.uet.edu.al/</a>"</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

**Standardi IV.6**


**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------



Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Njësitë përbërëse të UET dhe departamenteve të tij, hartojnë projekt buxhetin në muajin tetor të çdo viti dhe për zbatimin e këtij buxheti, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku përcaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Për çdo veprim blerje dhe shitje zyra e financës pajiset me “Kërkesë për Lëvrim fondesh”, e miratuar nga Administratori. Veprimet e shoqërisë kryhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar duke siguruar transparencë të plotë. Raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.</p> <p><i>(Pasqyrat financiare me shënime (Ref. Nr. 50.1 – 50.3); Raportet e auditimit (Ref.Nr. 50.4 – 50.6)</i></p> <p><i>Ref. Ref. 002. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB – BA Arte Skenike</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. Konstatohet që hartohet plan financimi i posatshtëm për programin e studimit.</p> <p><i>Ref. 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime.</i>  <i>Ref. 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime.</i>  <i>Ref. 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.</i>  <i>Ref. 002. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB – BA Arte Skenike</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit. EEI shpk përgjatë vitit 2016-2017 ka marrë konsulencë financiare nga shoqëria “Deloitte Albania”. E.E.I. shpk përmbush kushtet për kryerjen e një ekspertize, prandaj çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare.</p> <p>Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit</p> <p><i>Ref. 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime.</i>  <i>Ref. 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime.</i>  <i>Ref. 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin</p>	<p>Nga takimi me instancat administrative në UET u evidentua se ka raport auditiv çdo vit. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe eficienten e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për</p>

eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	studentët.  <i>Ref. 50.4 Raport auditimi viti 2018</i> <i>Ref.50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.</i> <i>Ref.50.4 Raport auditimi viti 2018.</i> <i>Ref.50.5 Raport auditimi viti 2019.</i> <i>Ref.50.6 Raport auditimi viti 2020.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Nga aneks tabelat përmbledhëse mbi raportimet financiare vihet re se aftësitë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.  <i>Ref. 50.4 Raport auditimi viti 2018</i> <i>Ref.50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.</i> <i>Ref.50.4 Raport auditimi viti 2018.</i> <i>Ref.50.5 Raport auditimi viti 2019.</i> <i>Ref.50.6 Raport auditimi viti 2020.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga Universiteti Europian i Tiranës vëren se pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet bëhet në përputhje me kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes, të miratuara nga statuti i Universitetit, në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit 80/2015. Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Ato janë të parashikuara në nenin 48 të rregullores së organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore si dhe gjenden të publikuara në faqen elektronike të IAL. Kandidati duhet të ketë përfunduar Maturën shtetërore në vend ose e njëvlefshme me të. Diploma duhet të jetë e njohur nga struktura përkatëse e MASR dhe të plotësojë kriterin e meritës. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese (Guida UET), fushatat informuese mediatike, si edhe gjatë këshillimit në institucion. <i>Ref. Nr. 27.1.Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve</i>
<b>Kriteri 2.</b> Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje,	Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta


Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Kjo gjë pasqyrohet edhe në Rregulloren e Universitetit Europian të Tiranës , neni 31 mbi procedurat dhe kriteret e pranimit në Ciklin e Parë të Studimeve. Aty përcaktohen rregulla të qarta, të barabarta dhe të njëjta që garantojnë të drejta identike për çdo student në këtë program studimi, që nga faza e regjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve të tij.</p> <p><b>Ref. Nr. 5. Rregullore UET, neni 31</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni vëren se UET kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit bëhen publike përmes faqes ëeb të universitetit si dhe në rregulloren e këtij programi studimi gjithashtu dhe në përputhje me rregullat e vendosura nga ligjet dhe aktet nënligjore për arsimin e lartë, i dërgon në MASR. Po ashtu çdo person i interesuar mund të drejtohet dhe fizikisht pranë Zyres së Keshillimit Studentor. Të gjitha informacionet në lidhje me procedura dhe kriteret e pranimit, përparimit, vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të përcaktuara qartë në Rregulloren Mësimore .</p> <p><b>27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</b></p> <p><b>28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konkludon se institucioni ka një praktikë të miratimit të kriterëve të pranimit ku specifikohen lista e kriterëve për llogaritjen e pikëve të kandidatëve në programet e studimit të Artëve, Skenike. Programi i studimit pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të UET-it dhe sipas kriterëve specifike që mund të propozohen nga Departamenti dhe miratohen në Senatit Akademik. Numri maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre, bëhen publike çdo fillim viti akademik para fillimit të regjistrimeve.</p> <p><b>27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.</b></p> <p><b>(Takimet në institucion)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni konkludon se UET propozon mënyrën e pranimeve për studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme, dhe se Fakulteti miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, bazuar në propozimet e njësive bazë, në përputhje me përcaktimet e ligjit dhe të akteve nënligjore në fuqi. Komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit, i ngritur pranë çdo departamenti, mbi bazën e dokumentacionit që dërgon IAL përkatëse, përcakton detyrimet që do të ketë studenti nëse pranohet në atë program, sipas planit mësimor në fuqi, si dhe njohjes dhe shlyerjes së lëndëve me ekuivalencë. Studimet në FSHHAL mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarët etnikë jashtë kufijve shtetërorë si dhe nga çdo shtetas i huaj i cili ka njohuri të gjuhës shqipe. Kriteret për pranimet në programin e studimit bazohen në rregullore. Senati Akademik, bazuar tek kriteret që mund të përcaktohen paraprakisht nga Departamenti, miraton vendimin për kriteret e pranimit e përzgjedhjes së tyre dhe bëhen publike çdo fillim viti</p>

	<p>akademik para fillimit të regjistrimeve. Informacioni bëhet publik si online në rrjete sociale apo <i>ëeb</i>-in zyrtar, gjithashtu dhe nëpërmjet Zyrës së Pranimit, Zyrës së Këshillimit Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit apo prezantimit të tyre gjatë aktiviteteve si <i>tour-eve</i> në gjimnaze, <i>open days</i>, "Javet e Regjistrimit", etj.</p> <p><b>27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.</b></p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni verën se, në përputhje me Statutin e Universitetit dhe ligjit të arsimit të lartë, propozon përpara çdo viti akademik numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukurore të tij, sipas standardeve të cilësisë. GVJ bazuar në bisedat dhenë dokumentat e dorëzuar nga institucioni verën gjithashtu se Universiteti Europian i Tiranës, në fillim të vitit akademik dhe në vijimësi, në bashkëpunim me stafin akademik të FSHHAL, Zyres së Karrierës dhe Zyres së Marketingut (PR) përgatit dhe shpërndan materiale për publikun në lidhje me programet e studimit që ofron, zhvillon seanca të hapura me maturantët ku shpjegohen dhe orientohen një pjesë e elementeve që shoqërojnë veprimtarinë akademike.</p> <p><b>Ref. 51. Politika e marketingut të programit të studimit.</b></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td><b>Nuk përmbushet</b></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				X
<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			X						

<p><b>Standardi V.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të <i>ëeb</i> si dhe takimit me përfaqësues të tij, GVJ konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit (Pika 5.6 e Rregullores së programit: Kalimi në vitin pasardhës) dhe aktet e tjera rregullatore. Referuar rregullores mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin, edhe në këtë dokument përshkruhen procedurat përkatëse dhe parashikimet për regjistrimin përfundimtar në program për studentët që regjistrohen me transferim/mobilitetet. Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online UMS dhe LMS. Studentët e interesuar mund të tërheqin pranë koordinatores së Departamentit formularin e paradiplomimit, në të cilën gjenden të gjithë lëndët dhe rezultatet respektive, sikurse dhe statusi për çdo lëndë. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve si dhe mundësinë e transferimit të studimeve, instrumentat e realizimit të vlerësimit të njohurive për lëndë të ndryshme, komponentët përbërës të vlerësimit total të lëndës, organizimi i provimeve, realizimi i praktikave, përgatitja e punimit të diplomës, diplomimi, ndërpreja dhe rifillimi i studimeve, etj.</p> <p><b>Ref. 28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.</b></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare ëeb të UET si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni ndek procedurat në lidhje me transferimin e studimeve në përputhje dhe me bazën ligjore në fuqi (udhëzimi i MARS, nr. 17 datë 30.07.2019). Studentët informohen në lidhje me transferimin e studimeve, kur është e mundur, njohjen e kualifikimeve apo studimeve të pjesshme të realizuara në një institucion tjetër të arsimit të lartë. Gjithashtu mundësohet informacioni në lidhje me procesin e ekuivalentimit të studimeve, me universitetet e tjera jashtë vendit. Kriteret e transferimit të studimeve dhe ekuivalentimit sanksionohen qartë në rregulloren e UET. Po ashtu institucioni ka vënë në dispozicion dhe tabelën e transferimeve të studentëve prej dhe nga programi i studimit.</p> <p><b>Ref.28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në institucion si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga UET, GVJ konstaton se, përcaktimi i formës së vlerësimit të dijeve për lëndët specifike, bëhet nga pedagogu i lëndës si dhe pasqyrohet në silabusin e lëndës. Silabuset janë në dispozicion të studentëve në të gjitha format, si elektronikisht, përmes sistemit LMS, faqes së ëeb, ashtu edhe fizikisht në Departament përmes sekretarisë mësimore. Studentët pohojnë se njihen me format e vlerësimit të njohurive, nga komunikimi i drejtëpërdrejtë me pedagogët, qysh në fillim të procesit mësimor kur njihen me lëndën dhe në vazhdimësi.</p> <p><b>Ref. 46.3. UET LMS Guidë për studentet.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit, DAS ka miratuar kriteret që duhen plotësuar për të shkuar drejtë provimit të formimit apo mbrojtjes së punimit të diplomës. Dokumenti për punimin e diplomës, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike, e deri tek formatimin konkret të punimit, dorëzimin dhe mbrojtjen . Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Gjithashtu studentët njoftohen nëpërmjet e-mailit për çdo veprimtari akademike, nga koordinatoret e Departamenteve.</p> <p><b>10. Dokumenti B.11. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ, konkludon se, UET dhe FSHHAL ofron informacione në mënyrë periodike të organizuara në paraqitje të ndryshme, si gjatë tureve informuese në gjimnaze ashtu edhe gjatë vizitave në ambjentet e Universitetet. Gjithashtu UET zhvillon Open Days ku maturantët mund të vizitojnë nga afër institucionin e të ndjekin edhe orë të caktuara mësimi, si edhe Javën e Orientimit për studentët e rinj, përpara fillimit të vitit akademik. Përgjatë javëve të regjistrimit, UET vë në dispozicion të maturantëve të interesuar për të vazhduar studimet e larta, grupe pedagogësh sipas fakulteteve. Ata japin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë.</p> <p><b>Ref.48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online.</b></p>




	<b>Ref. 51. Politika e marketingut të programit të studimit.</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare ëeb të UET, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Këshillimit me stafin akademik në momentin që interesohen për programet e studimit;</li> <li>• Kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit;</li> <li>• Rregullores mësimore të programit të studimit;</li> <li>• Kontratës që nënshkruhet me UET në momentin e regjistrimit.</li> </ul> <b>(Takimet në institucion)</b> <b>Ref.27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit në Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet ëeb-it. Informacioni i nevojshëm publikohet në format letër, guida, rregullore dhe fletëpalosje, si dhe elektronikisht. Në formë të detajuar studentët kanë akses mbi ngarkesat, temat për çdo javë mësimore dhe literaturat e detyrueshme dhe ato të rekomanduara, detyrat apo diskutime të ndryshme edhe nëpërmjet LMS. Për studentët e vitit të dytë, marrin sërish informacion në momentin e përzgjedhjes së lëndës, nga pedagogu përgjegjës për këtë proces. <b>Ref.27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</b>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Në bazë të dokumentacionit të grupit të vetëvlerësimit, dhe gjatë takimeve të GVJ në institucion, u konstatuan përpjekje të vazhdueshme të UET, për të studiuar tregun e punës dhe kërkesat e kriteret e tij. Fakulteti zhvillon vazhdimisht takime, aktivitete dhe orë të hapura me përfaqësues të instituconeve të cilat ofrojnë mundësi punësimi. Studentët shpesh janë pjesë e këtyre takimeve dhe informohen përmes Zyrës së Karrierës dhe Alumnit pranë UET, për mundësitë e reja ku ta mund të aplikojnë. Studentët shprehen se Panairi vjetor i punës, u vjen shumë në ndihmë, për identifikimin e varianteve të reja të punësimit sipas profilit të tyre të studimit. Bordeve të tregut të punës – të cilat shërbejnë si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës. Zyra e Këshillimit të Karrierës ndihmon në krijimin e kontakteve/marrëveshjeve me kompani, organizata apo institucione në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të detyrueshme por dhe në aksesin në tregun e punës duke shpërndarë

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






	<p>informacion për vende potenciale, duke i trajnuar studentët në hartimin e CV, Letrës së motivimit &amp; Korrespondencën me zyrat e Burimeve Njerëzore, Mentorim &amp; Netëorking, organizimin e panairëve të punës, trajnime për intervista pune si dhe në krijimin e databazave dhe përpunimin e statistikave për punësimin e Alumni. Informacioni mbi orientimin e tregut të punës është i aksesueshëm për studentët, që ofrohet që nga faza para regjistrimit nëpërmjet aktiviteteve të organizuara nga institucioni si <i>tour-et</i> në gjimnaze, <i>open days</i>, Zyrës së Pranimet apo broshurave, faqes ëeb të institucionit apo e më tej gjatë fazës së regjistrimit me anë të Rregullores Mësimore të Programit të Studimit.</p> <p><b>Ref. Nr. 12.1, Bordi i Tregut të Punës 2018-2019</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare ëeb të UET dhe FSHHAL, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se studentëve, nëpërmjet ëeb-it, sekretarisë mësimore dhe stafit akademik, në mënyrë të vazhdueshme u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, numrin e lëndëve për çdo semestër, fillimin e mbarimin e semestrave, sezonin e provimeve, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Gjithashtu edhe biblioteka funksion dhe ofron kushte cilësore dhe një fond të mjaftueshëm botimesh hard copy dhe elektronikisht, shqip dhe anglisht kryesisht pa përjashtuar edhe gjuhët e tjera të mundshme të botimeve. Stafi IT së UET, ndihmon studentët me informacion mbi mënyrat dhe oraret e përdorimit të Bibliotekës.</p> <p><b>Ref. 46.3. UET LMS Guidë për studentet.</b></p>			
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit, UET LMS , e cila funksionon si nje database personal, studentët mund të aksesojnë programin, sylabuset, leksionet, notat dhe kreditet, oraret, etj. Nëpërmjet kësaj platformi, mundësohet dhe shkëmbimi i dorëzimit të punëve, shërben si forum komunikimi, shkëmbim mesazhesh, e njoftimesh. Stafi akademik ka gjithashtu akses për lëndët që është pjesëmarrës nga ku mund të menaxhoje literaturën e lëndëve perkatese, caktimin e detyrave të kursit, depozitimin e leksioneve, vleresimet, forume diskutimi online me studentët, etj. Nga takimi me studentët GVJ konstanton që materialet për lëndët që zhvillohen në këtë program studimi u mundësohen studentëve në momentin e regjistrimit të tyre, pajisen nga Zyra e IT, me një adresë emaili të UET. Kjo u mundëson studentëve që të marrin të gjitha informacionet që dërgohen nga koordinatori dhe jo vetëm. Gjithashtu, nëpërmjet sistemit LMS, studentët edhe pse mund të jenë në distancë, mund të marrin njoftimet e pedagogut të lëndës, orarin mësimor të personalizuar; njoftimet në nivel universiteti për të gjithë studentët; mundësi komunikimi me mesazhe, chat-e me pedagogët etj. Me anë të kësaj platforme, studentët kanë një informacion të plotë dhe të përditësuar në lidhje me programin e tyre.</p> <p><b>Ref.46.3. UET LMS Guidë për studentet.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b> X</p>




**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

**Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.

Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se UET disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të regjistruar në programin e studimit për çdo vit akademik, si dhe për numrin e studentëve të punësuar pas diplomimit në IAL. Institucioni nëpërmjet sistem të menaxhimit, administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.

V.A 2018-2019 (15 studentë)

V.A 2019-2020 (17 studentë)

V.A 2020-2021 (12 studentë)

V.A 2021-2022 (14 studentë)

**Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.**

**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon nga ana e UET bëhet kujdes për dokumentacionin që pasqyron çdo vit numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit. Informacioni disponohet nga Sekretaria mësimore, i pasqyruar në Regjistrin Themeltar, që tregon regjistrimet, pezullimet apo dhe ndërprerjet e studimeve. Regjistri ruhet fizikisht dhe elektronikisht për një periudhë kohore të pacaktuar. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Materialet janë të aksesueshme si në regjistra, ashtu dhe në sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit. Gjithashtu kopje dhe procesverbale gjenden dhe të printuara në dosjet përkatëse, përfshirë të studentëve.

**Ref. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.**


**Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se sekretaria mësimore ka përgjegjësinë dhe disponon në regjistër përkatës të gjitha të dhënat e studentëve nga pranimi deri në diplomim. Studentët kanë dosjet e tyre me të gjitha informacionet dhe dokumentat e dorëzuara që nga regjistrimi i tyre, përfshirë dhe infot në rastet e largimeve. Zyra e Kontratave, së bashku me Sekretarinë, bën regjistrimin paraprak të studentit dhe garanton/ ndjek plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin duke u kujdesur më tej për pajisjen me numrin e matrikullimit dhe regjistrimin dhe hedhjen e gjithë të dhënave për çdo student në UMIS-Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit. Database pasurohet me të dhëna të mëtejshme gjatë zhvillimit të programit të studimeve deri në diplomimin e tyre. Përveç informacioneve në UMS-University Management System, e cila shërben si database me informacionet bazë të çdo student, dhe kopje fizike të të gjithë informacioneve themeltare. Nëpërmjet kontaktit periodik me të diplomuarit, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Shoqatës Alumni,

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>gjeneron dhe informacione në lidhje me punësimin e tyre duke nxitur kështu dhe një njohje më të mirë të tregut apo krijimin e urave lidhëse me të .</p> <p><i>(Takimi ne sekretarine mesimore)</i></p> <p><b>Ref. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni përdor Sistemin UMIS, ku çdo student është i pajisur me username dhe passëord unik, duke i mundur kështu shërbimet e sekretarisë mësimore, pa frekuentuar ambjentet fizike të Sekretarise në Universitet. Kështu gjurmohen edhe studentët aktivë, gjatë ciklit normal të studimeve. Përmbajtja e informacioneve/njofimeve që lidhen me UMIS administrohen nga personi pranë Zyrës IT-së me detyrë funksionale menaxhimin teknik të sistemit UMIS. Aksesit në hedhjen e të dhënave statistikore është i dedikuar vetëm për sekretarinë mesimore, dhe shfaq elementë të lartë mbrojtje nga ndërhyrjet. Përmes sistemit të brendshëm të informacionit UMIS-Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit. Përveç UMIS, sistemi është i përbërë dhe nga platforma tjetër, UET-LMS. Të dhënat janë lehtësisht të verifikueshme dhe aksesit i tyre bëhet nëpërmjet personave kompetentë/të autorizuar si IT apo sekretaria. Përveç sistemeve të elektronike, i gjithë informacione mbahet dhe në formë fizike. Institucioni krijon, përpunon dhe ruan dhe menaxhon përmes sistemit të brendshëm të informacionit të gjitha statistikatat në lidhje me aplikimet, regjistrimet, njohjet, pezullimet, cregjistrimet, vlerësimet, mesataret, diplomimet, etj.</p> <p><b>Ref.46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.</b></p> <p><b>Ref.46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</b></p> <p><b>Ref.46.2. UET LMS Guidë për pedagogun.</b></p> <p><b>Ref.46.3. UET LMS Guidë për studentet.</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, u konstatua se DIF, harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Informacioni transmetohet vit pas viti deri në diplomimin e studentëve dhe ruhet në Zyren e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor. Institucioni harton raporte në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Bazuar në dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton që institucioni kujdeset për marrjen e informacioneve për kerkesat e tregut me qëllim përmirësimin e treguesve të punësimit. Kjo arrihet nëpërmjet informacioneve të marra nga të diplomuarit nëpërmjet Zyrës Se Karrierës, Shoqatës Alumni, Bordeve të Tregut të punës si dhe nga studime periodike të tregut të punës .</p> <p><b>Ref. 001. RVB_BA Arte Skenike.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




**kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.

Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi se, UET ka parashikuar në organizimin dhe funksionimin e tij pjesëmarrjen e studentëve. Në Statutin e UET është e përcaktuar që dy anëtarë të Senatit Akademik janë student. Ndër strukturat kryesore përmendim:

Këshilli i Studentëve - realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese.

Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve.

Këshilli Etikës - një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve.

KSBC – ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve.

Mbledhjet e departamenteve, një në muaj është e hapur për studentët.

Studentët përfshihen edhe në procese të tjera vendimmarrëse, si dhe përfaqësohen në Komisionet për Sigurimin e Cilësisë dhe në Këshillin e Etikës.

*Ref. Nr. 2, Statuti UET, Neni 16, 19 dhe 51*

**Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate ieltësisht të verifikueshme e të matshme.

Në Statutin e IAL është e përcaktuar që një prej anëtarëve të NJSBC-së është anëtar i Këshillit Studentor. Po kështu, edhe në grupin e brendshëm të vlerësimit (GVB), në kuadër të procesit të akreditimit njeri prej anëtarëve është student. Një mënyrë tjetër janë dhe “Focus Group”-et , me grupe studentësh të programeve përkatëse, për të trajtuar shqetësimet dhe pritshmëritë e tyre. Gjithashtu, vetë Departamenti kryen mbledhje të hapura me pedagogë e studentë për të kontrolluar mbarëvajtjen e studimeve dhe për të shprehur të gjithë mendimet apo problematikat nga studentët. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave përpërmirësim të vazhdueshëm. Një student i programit BA Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji është pjesë e GVB të ngritur në kuadër të hartimit të këtij raporti.

*Ref. 2. Statuti UET.*

**Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.

Në dokumentacionin e dorëzuar nga GVB, arrijmë në konkluzionin se, FSHHAL, ofron mundësinë e transferimit të studimeve. Transferimet pranohen në fillim të çdo vit akademik, jo më vonë se java e pestë e semestrit të parë.Periodat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit të shlyera në institucionet e tjera të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, njihen dhe njehsohen, në një program të njejtë ose të ngjashëm studimi. Procesi i transferimit të studimeve është i rregullt dhe me proceduara të përcaktuara qartë në rregullore. Vendimin për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve e merr Komisioni i Ekuivalentimit të Njësisë Bazë.

*Ref. 28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.*



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon siç u shprehem edhe më sipër, në UET garantohet përfshirja e studentëve në procese të ndryshme vendimmarrëse apo të tjera, gjithë që realizohet edhe në rastin e rishikimit për përmirësim të programit. Institucioni ka një sërë mekanizmash të cilat i mundësojnë studentëve të jenë pjesë e përmirësimit të programeve. Kjo është e mundur së pari nga vlerësimet e vecanta që i bëjnë çdo lëndë, të cilat mund të japin inpute pedagogëve, përgjegjësve të grup lëndëve, koordinatorëve, drejtuesve të departamentit, KBSC, etj., për të përmirësuar syllabuset dhe vetë lëndët. Mundësia e pjesëmarrjes në mbledhjet e departamenteve (një here në muaj) apo <i>focus grupet</i> i jep mundësinë që paraqesin problematikat dhe kërkesat e tyre në lidhje me përmirësime të programit. Gjithashtu i rëndësishëm është dhe përfaqësimi i tyre në organet drejtuese dhe vendimmarrëse.</p> <p><b>Ref. 001. RVB_BA Arte Skenike vizitës në institucion</b></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se personeli akademik e ka në vëmendje barazinë dhe meritokracinë e studentit në vlerësim dhe në mënyrë hierarkike shqyrtohet çdo ankimim. Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashtrajnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës.</p> <p><b>Ref. 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve</b></p>		
<p><b>Shkalla e përnibushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përnibushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përnibushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përnibushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

<p><b>Standardi V.6</b>  <b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë ielhtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe bisedës me institucionin GVJ konkludon se në Universitetin European te Tiranës funksionon Zyra e Kujdesit ndaj Studentit. Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Tutoriati dhe këshillimi akademik, sikurse dhe këshilluesit e karrierës në çdo Departament janë gjithashtu në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve.</p> <p><b>Ref. 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe bisedës me institucionin vihet re se veprimtaria e Zyres së Këshillimit të Karrierës orientohet drejt informimit të studentëve dhe këshillimit të tyre në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre paraqet, mundësitë e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

procesin mësimor dhe programin e studimit.	punësimin në të ardhmen, etj. <i>Ref. 001. RVB_BA Arte Skenike. takimet në Institucion</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Bazuar në dokumentacionin dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion Zyra për Këshillimin e Karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Detyrat dhe funksionimi i Zyres së Këshillimit të Karrierës në Universitetin Europian të Tiranës është që ndërmjetësojë dhe të japë informacion në lidhje me bursa, trajnime, shkëmbime studentore. <i>Ref. 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ evidenton se Zyra për Këshillimin e Karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledhë dhe përpunon të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse. Këtë analizë e kishte bërë për disa programe e studimit në të cilat ka studentë të diplomuar. Gjatë bisedës në Institucion, GVJ-së në takimin me pedagogët që japin mësim në këtë program studimi, si dhe me studentët e këtij program studimi u bë me dije se një pjesë e studentëve të vitit të trete tashmë ishin angazhuar në internshipe. <i>Ref. 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konfirmon se UET, disponon strukturën dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Neni 103, Pika 1. Në manualin e Cilësisë UET përcaktohen korniza e sigurimit të cilësisë, bordi i administrimit dhe njësitë përkatëse. <i>Ref. Nr. 2. Statuti UET, Neni 11&amp;16;</i> <i>Ref. Nr. 5, Rregullore UET, Neni 6;</i> <i>Ref. Nr. 8, Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur	GVJ, gjatë vizitës në institucion, konstatoi se Sistemi i Brendshëm i

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Cilësisë, funksionon si një rrjet i mirëorganizuar dhe shtrin funksionin e tij në të gjitha njësitet organizative të UET. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ka si përfaqësues një koordinator nga secila njësi kryesore e UET dhe përfaqësues nga studentët.</p> <p><b>Ref. Nr. 30, Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC_Tabela 24 Aneks ;</b> <b>Ref. Nr. 30.4. Urdhër mbi përbërjen e KSBC</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Nga Shqyrtimi i dosjes së dorëzuar të GVB, konstatoam se grupi ynë i akreditimit për programin Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji, është duke kryer procesin e parë të vlerësimit të jashtëm të cilësisë. Në këtë drejtim, në UET është zbatuar procesi i kontrollit të ligjshmërisë i ushtruar nga MASR në vitin 2014, sipas së cilit UET plotësonte standardet dhe kriteret ligjore për ushtrimin e aktivitetit akademik; janë zhvilluar vizita monitoruese të MASR mbi përmbushjen e kapaciteteve akademike dhe infrastrukture në funksion të miratimit të kuotave për çdo vit akademik.</p> <p><b>Ref. 2. Statuti UET.</b> <b>Ref. 001. RVB_BA Arte Skenike.</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, vërejtëm se, veprimtaria e KSBC mbështetet në dokumentet e saj strategjike dhe zhvillohet e organizuar sipas një plani kalendar (Plani i veprimit) të përvitshëm, në të cilin programohen sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet dhe gjetjet përkatëse. Në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e njësive, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p> <p><b>Ref. 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Niveli i përmbushjes</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>KSBC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit. Në funksion të garantimit të cilësisë, rol të rëndësishëm kanë departamentet si njësia përgjegjëse për programin e studimit, ku përgjegjësit e gruplëndëve/koordinatorët e programeve kanë detyra specifike që lidhen me çështjet e rishikimit të kurrikulës, silabuseve dhe literaturës në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe standardet dhe Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë së UET.</p> <p><b>Ref. Nr. 36, Vendimi për emërimin e Koordinatorëve të programeve të studimit ;</b></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	<b>Ref. Nr. 30.3. Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022</b>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Procedurat e rishikimit periodik të programeve të studimit, përgatiten dhe shpërndahen në formën e një raporti vlerësues periodik mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel Rektorati, sikurse dhe në nivel departamenti. <b>Ref. Nr. 30.5 Metodologjia e punës së KSBC_Provimet</b>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues që organizohen nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), për secilin nga proceset akademike që monitorohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. KSBC njëherazi, rekomandon detyra, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe nga vet Komisioni. <b>Ref. Nr. 30.7, Shpërndarja e relacionit të KSBC për monitorimin e silabuseve</b>			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Ky kriter plotësohet pasi rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse sikurse dhe titullarit të lëndës, përgjegjësve të grup-lëndëve, përgjegjësit të departamentit. <b>Ref. Format i relacionit për monitorimin e silabuseve</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë. KSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë, monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive. <b>Ref. Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.3-7</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	GVJ nga takimi me përfaqësues të institucionit konkludon se në mënyrë periodike institucioni është kujdesur për vlerësimin e brendshëm si në nivel fakulteti ashtu dhe departamenti duke hartuar raport përkatës të veprimtarisë. Ky raport shërben si dokument bazë për vetëvlerësimin e programeve të studimit. Gjithashtu raportet e vlerësimit të brendshëm ishin pjesë e dokumentacionit të shfrytëzuar gjatë procesit të akreditimit institucional.  <b>Takimi me KSBC)</b>
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në	Sipas takimit me përfaqësues të institucionit metodat e përdorura përfshijnë instrumenta për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësinë e literaturës, proceset didaktike të përdorura dhe konferencat e realizuara. Për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, realizon pyetësorë,

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






<p>përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>ku studentët japin mendimin e tyre në lidhje me zhvillimin e komponentëve të modulit, përgatitjen e pedagogut, sjelljen etij, etj. Studentët shprehin mendimin e tyre në sondazhe, intervista të ndryshme të realizuara nga Zyra e Karrierës dhe Alumni, apo nga punë dhënës të ndryshëm. Instrumentet kryesor që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe zhvillimi i pyetësorëve online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve, etj.</p> <p><b>Ref. 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit _BA Arteve Skenike.</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UET në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Teste të standardizuara;</li> <li>- Dëgjime në auditor;</li> <li>- Vlerësimi me pikë;</li> <li>- Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module; praktikë;</li> <li>- Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët;</li> <li>- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës.</li> </ul> <p>Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe vizitat nga epori (Përgjegjës/Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me plotësimin e një raporti vlerësimi. Në kushtet e vijimit të procesit akademik online përmes platformave UET LMS dhe Microsoft Teams, sipas Vendimit të Senatit Akademik, monitorimi i zhvillimit të leksioneve dhe seminareve është mundësuar nga Zyra e IT në UET nëpërmjet raporteve të vazhdueshme mbi aksesimin e platformave nga stafi akademik/studentët dhe prezencën në mësim, mbi kohëzgjatjen e orëve mësimore, etj. Lidhur me cilësinë dhe metodologjitë e mësimdhënies, orët mësimore janë monitoruar nga Përgjegjësi i Departamentit.</p> <p><b>Ref. 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu.</b></p> <p><b>Ref. 40. G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët.</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentat e vëna në dispozicion dhe takimi me përfaqësues të tij se ka zhvilluar pyetësor anketues me studentë me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të studentëve në programe specifike. Metodatat e tërthorta përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve.</li> <li>• Sondazhe: të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit.</li> <li>• Pyetje konceptuale.</li> <li>• Intervista.</li> </ul> <p>Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesëve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si dhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre.</p> <p><b>Ref. G.III.4.2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në manualin e Cilësisë të UET, përcaktohet roli i strukturave akademike dhe administrative si dhe roli i Senatit Akademik lidhur me sigurimin e Cilësisë. Një nga këto politika, është ngritja pranë departamenteve e organeve këshilluese të Bordeve të Tregut të Punës. Po ashtu, përfshirja dhe angazhimi në KSBC i një eksperti të jashtëm i përgjigjet nevojës së Universitetit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm. Gjatë periudhës 2016-2019, UET ka arritur të sigurojë përfshirjen si partner në dy projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë: projekti TEMPUS "ENCHASE" dhe projekti Erasmus+ QAINAL. Aspektet pozitive të përfshirjes në këto projekte lidhen me shkëmbimin e përvojave, njohja me qasje të reja dhe të ndryshme, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimin e akteve rregullore, metodologjisë dhe instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Lidhur me sigurimin e cilësisë, ka patur gjithashtu shkëmbime të stafit akademik dhe administrativ – me fokus në mësimdhënie dhe trajnim – në kuadër të projektit Erasmus+ KA1.</p> <p><i>Fisha e projektit ENCHASE</i>  <i>Fisha e projektit QAINAL</i>  <i>Ref. Nr. 30.3, Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Studentët përfshihen në vlerësim përmes anketimit, dhe forumeve të debatit. Përfshihen edhe në vendimmarrje përmes përfaqësisë së tyre në Senatin Akademik, si pjesë e Qeverisjes së UET, përfaqësisë në Komisionin e Etikës, Këshillit studentor, si dhe përfaqësisë në NJSBC.</p> <p><i>Ref. 2. Statuti UET.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, mund të pohojmë një gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit Administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme të Departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësim apo ndryshime në programet e studimit.</p> <p><i>(Takimet ne Institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Fakulteti është i angazhuar në respektimin e integritetit akademik dhe në shmangien e çdo diskriminimi apo pabarazie të gjithë palëve të përfshira në këtë proces. Procesi i vlerësimit zhvillohet duke respektuar Kodin e Etikës dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik dhe studentëve. Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, DAS ka krijuar grupet e punës që sigurojnë këtë të fundit në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	shkencore dhe vëmendjes ndaj studentëve.			
	<i>Ref. 2. Statuti UET.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Përveç vlerësimit të brendshëm, element tjetër i sigurimit të cilësisë është dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit, ku pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësim të përmbushjes së standardeve të cilësisë.			
	<i>Ref. 2. Statuti UET.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Çdo informacion në lidhje me politikat dhe praktikën që lidhen me sigurimin e Cilësisë në UET është i aksesueshëm nga i gjithë stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët. Veprimtarinë e saj KSBC-ja e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendar, Planit të veprimit, të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet e detajuara dhe raportet përmbledhëse me gjetjet përkatëse. <i>Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga kontakti me përfaqësues të institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar prej tyre konstatohet se institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. Kanë miratuar rregullore për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave. Në faqen ëeb publikohen të gjitha politikat dhe praktikën e sigurimit të cilësisë të cilat janë të aksesueshme për të gjithë. <i>(Takimi me KSBC)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nisur nga analiza e raporteve të vlerësimit, Stafet angazhohen në plotësimin e rekomandimeve, ndjekjen e udhëzimeve për veprimet e marra. Masat, që synojnë përmirësimin e elementëve të evidentuara për rishikim, dokumentohen në formën e planeve të masave me qëllim përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Në zbatim të rekomandimeve angazhohet stafi akademik dhe ai ndihmës akademik. <i>(Takimi me KSBC)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim	GVJ konkludon në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni se ai vlerëson dhe përpiket për efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive për monitorimin e cilësisë me qëllim përmirësimin e programit të studimit. Konkretisht cdo vit realizohet analiza e punës

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




të cilësisë së programit të studimit.	<p>mësimore e cila shoqërohet nëpërmjet “kontrollit të kryqëzuar” (crosscheck) që implementohet nga struktura dhe aktorë të brendshëm në UET, duke filluar nga njësitë bazë nëpërmjet drejtuesit të departamentit, përgjegjësit të grup-lëndëve e koordinatorit të programit, te strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><b>Ref. 30.1. Plani veprimt KSBC</b>  <b>Ref. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave</b>  <b>ref. Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</b></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>Mbledhjet e Asamblesë Akadematike si dhe mbledhjet e Departamentit, përbëjnë dhe mënyrat më të shpeshta të informimit mbi arritjet dhe problematikave; në këto mbledhje bëhet identifikimi i nevojave për ndërhyrje për përmirësim.</p> <p><i>(Takimi ne Institucion)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Bachelor në “Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji” të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti European i Tiranës**

**Pikat e forta**

1. Departamenti i Arteve të Aplikuara ka në përbërjen e tij një trupë pedagogjike të përbërë nga personalitete nga fusha e arteve të cilët kanë qenë dhe mbeten protagonistë në zhvillimet e sotme artistike dhe kulturore, jo vetëm në krijimtari por edhe sa i përket hulumtimit dhe kërkimit shkencor. Angazhimi i tyre akademik përkon edhe më ofrimin e një infrastrukture të përshtatshme për të zhvilluar veprimtarinë e tyre akademike. Në të njëjtën kohë projektimi dhe zbatimi i një sërë projektesh të rëndësishme si ato me partneritet shqiptar, ashtu edhe ato me mbështetje dhe partneritet ndërkombëtar, ndikojnë në përmbushjen e të gjitha objektivave të përcaktuara dhe të synuara nga departamenti. Gjithashtu, organizimi i një sërë veprimtarish artistike dhe kulturore në universitet, ku studentë dhe pedagogë performojnë së bashku për publikun e pranishëm, ndikon në praktikimin dhe marrjen e përvojës së drejtpërdrejtë në krahasim të emrave dhe personaliteteve të shquara të artit dhe kulturës shqiptare.
2. Kurrikula e programit të ofruar është konform kërkesave reale të tregut të punës në fushën e arteve pamore. Programi krijon mundësi që student të zhvillojnë kreativitetin, performimin në publik, shprehjet artistike, njohuritë teknike dhe ato teorike të cilat janë të nevojshme në zhvillimin e profesionistëve të së ardhmes. Formimi praktik - artistik komplementohet me bazën e shëndoshë teorike. Kjo balance në formimin ka shfaqur sukses në punësimin e ish-studentëve të diplomuar (Alumni) në programin “BA Arte Skenike me profile: Aktrim, Balet, Marrëdhënie Publike, Regji”.
3. Stafi akademik është i kualifikuar dhe me përvojë në fushat përkatëse. Ky është faktor i rëndësishëm në mësimdhënie, dhe rrejdhimisht në formimin akademik të studenteve të programit. Disa prej personaliteteve të kulturës shqiptare janë gjithashtu pedagogë të programit.
4. Fakulteti, Departamenti që ofron këtë program dhe UET kanë lidhur marrëveshje me institucione dhe biznese të ndryshme për praktikat profesionale të studentëve në përfundim të studimeve të tyre.
5. Panairët e punës të organizuar nga Departamenti i Arteve dhe UET krijojnë mundësinë e lidhjes së kontakteve me studentët dhe aktorët apo agjentët e ndryshëm të tregut të punës.
6. Në të njëjtën kohë projektimi dhe zbatimi i një sërë projektesh të rëndësishme si ato me partneritet shqiptar, ashtu edhe ato me mbështetje dhe partneritet ndërkombëtar, ndikojnë në përmbushjen e të gjitha objektivave të përcaktuara dhe të synuara nga departamenti. Bashkëpunimi me institucione dhe subjekte të njohura si Teatri Kombëtar, Kompania Filmike AA, Qendra Kombëtare e Librit, Mediat e ndryshme si Top Channel, Radio Televizioni Publik Shqiptar, "48 Hour Film Project", platforma “Harabel”, Kënga Magjike apo me atelie të ndryshme e kanë rritur së tepërmi mundësinë dhe hapësirën e zbatimit të një programi të detajuar ku studenti përveç anës teorike, ushtrohet dhe aftësitë e tij promovohen edhe në skenë apo në ambientet më të njohura artistike në vend.
7. UET dhe Departamenti i Arteve të Aplikuara zhvillojnë vazhdimisht aktivitete fromuese dhe promovuese në benefit të studentëve, si dhe takime të ndryshme me personalitete të fushave të Artit, gjë që ndikon pozitivisht në formimin e njohurive dhe krijimin e përvojave të reja në krijimtarinë artistike të studentëve.
8. Angazhimi i stafit pedagogjik dhe studentëve nëpër projekte të ndryshme, në partneritet me shkollën por edhe përtej (si program Erasmus+ apo trajnimet që ofron shkolla), krijon



përvoja të reja arsimore, gjë që ndikon pozitivisht në marrëdhënien student-pedagog, dhe rrjedhimisht në formimin më të kompletuar akademik të studentëve.

9. Teknologjia bashkëkohore në edukim, e ofruar si në auditorët / mjediset e shkollës, ashtu edhe online ka ndihmuar së tepërmi në shpjegim, ndëveprimin midis studentëve dhe pedagogëve dhe vijueshmërinë e seancave mësimore edhe në rastet kur studentët ndodhen larg. Mësimdhënia online ka shfaqur shenja suksesi sidomos në rastin e lëndëve teorike (të Tipologjisë II).

### **Pikat e dobëta**

1. Duke patur parasyh që vitet e Pandemisë ndaluan dhe detyruan universitetet ti përshtateshin një realiteti të ri, dhe UET mori një sërë masash konform problematikave të reja dhe zgjidhjes së tyre. Si pasojë, e vendimit të marrë nga Senati akademik, praktikat profesionale u zhvilluan online përmes platformës Microsoft Teams, ku ishin të ftuar pjesëtarë nga Bordet e Tregut të Punës apo aktorë të ndryshëm të biznesit në Shqipëri. Duke qenë se programi ka një qasje artistike me bazë metodologjinë praktike, kjo ka paraqitur vështirësi tek studentët në zhvillimin e praktikave profesionale, pasi krejt veprimtaria e subjekteve publike dhe private e ndryshoi qasjen e saj ndaj publikut, gjë e cila e kushtëzoi zhvillimin e praktikës në mënyrë më të drejtpërdrejtë me zhvillimin, organizmin dhe angazhimin me kohë të plotë në projekte apo programe specifike dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me publikun. **(Standardi IV.3/kriteri 5)**

### **Rekomandime**

1. GVJ rekomandon rritjen e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve, dhe stimulimin e mbështetjen e tyre më tej në ekspozita, biennale ndërkombëtare dhe botime shkencore me impakt e vizibilitet të lartë.
2. Rekomandohet angazhimi i ekspertëve, artistëve ndërkombëtarë në fushat e artit bashkëkohor, të ftuar për leksione e seminare ose ëorkshope. Një zgjerim i mëtejshëm i ekspozimit kërkimor kombëtar dhe ndërkombëtar mund të arrihet përmes shkëmbimit dhe bashkëpunimit me universitete e tjera në trevat shqipfolëse, si dhe me pedagogë shqiptarë të cilët janë pjesë e diasporës në universitete ndërkombëtare. Këto pika do të ndikojnë në një prani dhe ndikim të programeve përtej kontekstit e arenës kombëtare e të krijohet profili ishollës si një 'markë' të identifikueshme në kontekstin kombëtar.
3. Institucioni vë në dispozicion laboratorë-atelje për zhvillimin e mësimdhënies dhe praktikës mësimore. Pavarësisht punës së kryer derimë tani, rekomandohet që të vijojë pasurimi i tyre për të garantuar një përditësim sa më të mirë të tyre



**Conclusions of the Evaluation of the second cycle Bachelor's study program in "Performance Arts with profiles: Acting, Ballet, Public Relations, Directing" of the Institution of Higher Education, European University of Tirana**

**Strengths**

1. The Department of Applied Arts has in its composition a pedagogical team composed of personalities from the field of arts who have been and remain protagonists in today artistic and cultural developments, not only in creativity but also in terms of research and research scientific. Their academic commitment also coincides with the provision of an appropriate infrastructure to develop their academic activity. At the same time, the design and implementation of a number of important projects, both those with Albanian partnership and those with international support and partnership, affect the fulfillment of all the objectives set and targeted by the department. Also, the organization of a series of artistic and cultural activities at the university, where students and lecturers perform together for the present public, affects the practice and receiving direct experience alongside the prominent names and personalities of Albanian art and culture.
2. The curriculum of the offered program conforms to the real demands of the labor market in the field of visual arts. The program creates opportunities for students to develop creativity, public performance, artistic skills, technical and theoretical knowledge which are necessary in the development of future professionals. The practical-artistic training is complemented with a sound theoretical basis. This balance in training has shown success in the employment of former graduate students (Alumni) in the program "BA Performing Arts with profiles: Acting, Ballet, Public Relations, and Directing".
3. The academic staff is qualified and experienced in the relevant fields. This is an important factor in teaching, and consequently in the academic formation of the students of the program. Some of the personalities of the Albanian culture are also lecturers of the program.
4. The Faculty and the Department that offers this program have concluded agreements with various institutions and businesses for professional internships for students at the end of their studies.
5. The job fairs organized by the Department of Arts and UET create the possibility of connecting contacts with students and different actors or agents of the labor market.
6. At the same time, the design and implementation of a number of important projects, both those with Albanian partnership and those with international support and partnership, affect the fulfillment of all the objectives set and intended by the department. Cooperation with well-known institutions and entities such as the National Theatre, the AA Film Company, the National Book Center, various media such as Top Channel, Albanian Public Radio, "48 Hour Film Project", the "Harabel" platform, the Magic Song or with workshops of various have greatly increased the possibility and space of implementing a detailed program where, in addition to the theoretical side, the student exercises and his skills are promoted on stage or in the most popular artistic venues in the country.
7. UET and the Department of Applied Arts constantly develop educational and promotional activities for the benefit of students, as well as various meetings with personalities from the fields of Art, which positively affects the formation of knowledge and the creation of new experiences in the artistic creativity of to the students.



8. The engagement of teaching staff and students in various projects, in partnership with the school but also beyond (such as the Erasmus+ program or the training offered by the school), creates new educational experiences, which positively affects the student-teacher relationship, and consequently the most complete academic formation of students.
9. Contemporary technology in education, offered both in classrooms/school environments and online has greatly helped in explanation, interaction between students and lecturers and continuity of teaching sessions even when students are far away. Online teaching has shown signs of success, especially in the case of theoretical subjects (Typology II).

### Weak points

1. Bearing in mind that the Pandemic years stopped and forced the universities to adapt to a new reality, and UET took a series of measures in accordance with the new problems and their solution. As a consequence of the decision taken by the academic Senate, the professional practices were developed online through the Microsoft Teams platform, where participants from the Labor Market Boards or various business actors in Albania were invited. Since the program has an artistic approach based on practical methodology, this has presented difficulties to students in the development of professional practices, since all the activity of public and private entities changed its approach to the public, which conditioned the development of practice in more directly with development, organization and full-time engagement in specific projects or programs and direct communication with the public. **(Standard IV.3/criterion 5)**

### Recommendations

1. GVJ recommends increasing the mobility of academic staff and students, and stimulating and supporting them further in exhibitions, international biennials and scientific publications with high impact and visibility.
2. It is recommended to engage experts, international artists in the fields of contemporary art, invited for lectures, seminars or workshops. A further expansion of national and international research exposure can be achieved through exchange and cooperation with other universities in Albanian-speaking regions, as well as with Albanian pedagogues who are part of the diaspora in international universities. These points would influence a presence and influence of the programs beyond the context of the national arena and create the profile of the school as an identifiable 'brand' in the national context.
3. The institution provides laboratories-workshops for the development of teaching and teaching practice. Despite the work done so far, it is recommended to continue their enrichment to guarantee a better update of them





**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLLRËSIMI TËRËSOR				X

